

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Kualifikimin Profesional

DIZENJIM DHE DEKORIM I AMBIENTEVE TË BRENDSHME

Niveli V i KSHK¹, referuar nivelit V të KEK²
(2 vjeçar)

Kodi: B1-V-25

(Hartuar me mbështetjen e Projektit ProSEED 2.0 - GIZ)

Miratoi:

MINISTRI

1. Korniza Shqiptare e Kualifikimit
2. Korniza Evropiane e Kualifikimit

Tiranë, 2025

Përmbajtja:

I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V (pas të mesmes) i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK.

1. Kërkesat e pranimi të nxënësve në arsimin profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK.

III. Plan i mësimor për kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK.

IV. Udhëzime për planin mësimor.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK.

VIII. Përshkruesit e moduleve profesionale teorike/praktike.

IX. Programi i përgjithshëm i praktikës profesionale të grupuar, në biznes.

X. Programi orientues i provimeve përfundimtare të nivelit.

I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK (pas të mesmes).

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me dizenjimin dhe dekorimin e ambienteve të brendshme, si dhe për krijimin dhe menaxhimin e një biznesi privat, si person fizik ose juridik”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme” niveli V i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë/rejat që:

- kanë përfunduar të paktën një kualifikim profesional të nivelit IV në KSHK në drejtimet Ndërtim, Arte figurative ose kanë përfunduar arsimin e përgjithshëm në nivelin IV në KSHK dhe kanë të paktën një vit përvojë pune, të vërtetuar, në fushat ndërtim dhe arte të bukura;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, Ministria përgjegjëse e AFP-së përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi në këtë kualifikim.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efikente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë dhe të ushtrojë kompetencat profesionale, si më poshtë:

- Të zbatojë kuadrin ligjor bazë në fushën e dizenjimit dhe dekorimit të ambienteve të brendshme;
- Të zbatojë rregulloret dhe standardet teknike për dizenjimin dhe dekorimin e ambienteve të brendshme;
- Të analizojë terrenin dhe objektin ku do kryhen dizenjimi dhe dekorimi i ambienteve të brendshme;
- Të planifikojë burimet e nevojshme materiale, njerëzore dhe financiare për realizimin e projektit dizenjues dhe dekorues të ambienteve të brendshme;
- Të planifikojë proceset e punës për dizenjimin dhe dekorimin e ambienteve të brendshme;
- Të bëjë organizimin e punës në veprimtaritë që lidhen me dizenjimin dhe dekorimin e ambienteve të brendshme;
- Të përdorë dokumentacionin teknik për dizenjimin dhe dekorimin e ambienteve të brendshme
- Të përzgjedhë, përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet, instrumentat dhe materialet e punës të dizenjimit dhe dekorimit të ambienteve të brendshme.
- Të zhvillojë koncept dizajnin për një hapësirë të caktuar.
- Të analizojë veçoritë funksionale dhe estetike të stileve të dizajnit të brendshëm
- Të ndërtojë vizatime në projeksione ortogonale.
- Të realizojë figura gjeometrike në hapësirë.
- Të zbatojë teknikat e vizatimit teknik me dorë dhe digjital.

- Të përdorë në mënyrë efektive ngjyrat, ndriçimin natyral dhe artificial në projektimin e ambienteve të brendshme.
- Të projektojnë dhe dekorojnë hapësira të brendshme të ndryshme.
- Të zbatojnë standardet e projektimit dhe organizimit të hapësirës.
- Të përdorë tekstura dhe materiale ekologjike në funksion të dizenjimit dhe dekorimit të ambienteve të brendshme.
- Të përdorë realitetin virtual dhe renderimin në funksion të dizenjimit dhe dekorimit të ambienteve të brendshme.
- Të montojnë dhe instalojnë struktura ndërtimore dhe dekorative në ambientet e brendshme.
- Të prezantojnë konceptet e dizajnit për klientët duke përdorur teknika vizuale dhe grafike.
- Të zhvillojnë zgjidhje kreative për optimizimin funksional dhe estetik të hapësirave të brendshme.
- Të përzgjedhë dhe kombinojnë materiale, ngjyrat, mobilet dhe elementet dekorative sipas kërkesave të projektit dhe klientit.
- Të zbatojnë parimet ergonomike dhe funksionalitetin në dizenjimin e hapësirave të brendshme.
- Të bashkëpunojë me arkitektë, inxhinierë, ndërtues dhe mjeshtër teknikë për realizimin e projektit.
- Të monitorojnë ecurinë e punimeve në përputhje me projektin dhe standardet cilësore.
- Të vlerësojnë impaktin mjedisor dhe të përzgjedhë materiale të qëndrueshme dhe ekologjike në dizejnim.
- Të zhvillojnë aftësi për komunikim profesional dhe prezantim të ideve për klientët apo grupin e punës.
- Të plotësojnë dokumentacionin teknik që lidhet me punimet e dizenjimit dhe dekorimit të ambienteve të brendshme;
- Të kryejnë llogaritjet ekonomike për punimet e dizenjimit dhe dekorimit të ambienteve të brendshme;
- Të plotësojnë dokumentacionin financiar për punimet në dizenjimin dhe dekorimin e ambienteve të brendshme;
- Të ofrojnë këshilla teknike për klientët në lidhje me dizenjimin dhe dekorimin e ambienteve të brendshme;
- Të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për dizenjimin dhe dekorimin e ambienteve të brendshme;
- Të komunikojnë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së punimeve për dizenjimin dhe dekorimin e ambienteve të brendshme;
- Të angazhohet për zhvillimin e vazhduar profesional në fushën e dizenjimit dhe dekorimit të ambienteve të brendshme;
- Të përdorë mjete dhe programe digjitale në funksion të veprimtarisë profesionale të dizenjimit dhe dekorimit të ambienteve të brendshme.
- Të krijojnë dhe organizojnë portofolin profesional për projektin e zbatuar.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtëjshëm në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK.

Me përfundimin me sukses të arsimit në kualifikim profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V në KSHK, nxënësi pajiset me Certifikatën e aftësimit profesional dhe suplementin përkatës, që njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ai/Ajo mund t'i drejtohet tregut të punës si specialist në fushën e dizenjimit dhe dekorimit të ambienteve të brendshme në studio të dizenjimit të brendshëm, mobileri, studio arkitekture

(projektim dhe zbatim arkitekture), kompani ndërtimi (në fushën e zbatimit të projekteve të ndërtimit), kompani në fushën e organizimit të eventeve, në panaire dhe ekspozita, në institucione apo zyra private ose publike që merren me dizenjim dhe dekorim të ambienteve të brendshme, në media televizive (skenografi), zyra të ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme (real estate), si dhe të krijojë një biznes privat, si person fizik ose juridik për dizenjim dhe dekorim të ambienteve të brendshme.

Me përfundimin e suksesshëm të këtij niveli kualifikimi, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e studimeve të larta universitare për inxhinieri në drejtimin “Ndërtim” ose në drejtime të tjera.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK.

Plani mësimor për kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK (2 vjeçar)				
Nr	Kodi	Modulet dhe praktikat mësimore	Orët mësimore Viti I	Orët mësimore Viti II
A.		Modulet profesionale teorike/praktike. (Gjithsej)	900 orë mësimore	900 orë mësimore
1	M-02-2335-25	Bazat e dizenjimit të brendshëm	120	-
2	M-02-2336-25	Stilet në dizenjim dhe dekorim	120	-
3	M-02-2337-25	Gjeometri deskriptive	120	-
4	M-01-2338-25	Vizatimi teknik dhe digjital	180	-
5	M-02-2339-25	Ngjyrat dhe ndriçimi në hapësirë	90	-
6	M-02-2340-25	Projektimi dhe dekorimi i hapësirave të brendshme-1	150	-
7	M-02-2341-25	Standardet e projektimit dhe organizimi i hapësirës-1	120	-
8	M-02-2342-25	Projektimi dhe dekorimi i hapësirave të brendshme-2	-	150
9	M-02-2343-25	Standardet e projektimit dhe organizimi i hapësirës-2	-	140
10	M-02-2344-25	Tekstura dhe materialet ekologjike	-	90
11	M-02-2345-25	Realiteti virtual dhe renderimi	-	120
12	M-02-2346-25	Montimi dhe instalimi i strukturave në ambientet e brendshme	-	90
13	M-38-2347-25	Komunikimi profesional dhe menaxhimi i klientit	-	90
14	M-38-2348-25	Etika, komunikimi dhe sipërmarrja profesionale	-	70
15	M-05-2349-25	Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit	-	90
16	M-39-2350-25	Zhvillimi i portofolit profesional	-	60
B.	P-02-019-24	Praktika profesionale e grupuar në biznes (Gjithsej)	150 orë mësimore	150 orë mësimore
Gjithsej A+B			1050 orë mësimore	1050 orë mësimore

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor në kualifikimin profesional për “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK (pas të mesmes), zgjat 2 vite mësimore.

Viti i I-rë mësimor ka 33 javë (30 javë mësim teorik/praktik + 3 javë praktikë profesionale e grupuar, në biznes).

Viti i II-të mësimor ka 35 javë (30 javë mësim teorik/praktik + 3 javë praktikë profesionale e grupuar në biznes + 2 javë provime).

Një javë mësimore në shkollë ka 5 ditë x 6 orë në ditë = 30 orë mësimore.

Një orë mësimore teorike ose praktike zgjat 45 - 50 minuta.

Një ditë praktikë profesionale në biznes është 8 orë 60 minutëshe = 10 orë mësimore

Praktika profesionale në biznes në klasën I dhe II është 3 javë x 5 ditë/javë x 10 orë mësimore = 150 orë mësimore.

Kurrikuli i arsimit profesional në kualifikimin “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK, përbëhet nga modulet profesionale teorike, teoriko-praktike dhe praktike (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli), si dhe nga Programi i përgjithshëm i praktikës profesionale të grupuar, në biznes (tregohet në vijim të këtij dokumenti).

Rekomandohet që modulet profesionale praktike të realizohen në ndarje ditore 3 ose 6 orëshe. Përgjithësisht, renditja e realizimit të moduleve bëhet nga vetë shkolla, duke konsideruar parimet didaktike bazë (nga më e thjeshta te më e ndërlikuara, nga niveli i ulët te më i larti, nga teoria te praktika etj.), si dhe kushtet konkrete të shkollës. Për të rritur eficiencën e procesit mësimor, mund të realizohen paralelisht dy ose më shumë module, si dhe mund të zbatohet ndarja në grupe e nxënësve.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

1. Udhëzime për modulet profesionale teorike dhe/ose praktike.

Mësimdhënësit e moduleve profesionale teorike dhe/ose praktike duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme. E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e moduleve profesionale teorike/praktike të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbyshjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale që ofrojnë kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK.

Mësimdhënësit duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Detyrat praktike* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme

për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin përshkruesit e moduleve dhe programin e praktikës në biznes, në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

2. Udhëzime për praktikën profesionale të grupuar, në biznes:

Praktika profesionale e grupuar zhvillohet në mjediset e punës së bizneseve që kanë si veprimtari në fushën e dizenjimit dhe dekorimit të ambienteve të brendshme. Kjo praktikë profesionale ka për qëllim integrimin në mjediset reale të punës, të njohurive, shprehive dhe qëndrimeve të cilat i kanë fituar gjatë procesit mësimor teorik dhe praktik të zhvilluar më parë në mjediset mësimore teorike dhe praktike të shkollës. Praktika e grupuar në biznes realizohet çdo vit, gjatë një periudhe mësimore trejavore (150 orë mësimore), zakonisht në përfundim të procesit mësimor teorik dhe praktik, përpara provimeve përfundimtare. Kompanitë/bizneset ku do të kryhet praktika profesionale e grupuar, periudha e realizimit dhe programi i përgjithshëm i kësaj praktike (shih formatin në vijim të këtij dokumenti), përcaktohen nga vetë shkolla profesionale në bashkëpunim me bizneset përkatëse. Planifikimi, organizimi dhe administrimi i praktikës profesionale të grupuar, në biznes, bëhen në bashkëpunim të ngushtë me bizneset, në përputhje me kuadrin ligjor të posaçëm të shkollave profesionale, për praktikat profesionale në biznese

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në modulet profesionale teorike dhe/ose praktike bëhet nga vetë mësimmëdhënësit përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për modulet teorike/praktike, ashtu edhe për praktikën në biznes, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të kualifikimit profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK, nxënësi i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale në fushën e dizenjimit dhe dekorimit të ambienteve të brendshme.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, niveli V i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Certifikatën profesionale dhe Suplementin përkatës, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga Ministria përgjegjëse e AFP-së, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në modulet profesionale teorike /praktike dhe praktikën profesionale në biznes;
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit V të KSHK.

VIII. Përshkruesit e moduleve profesionale teorike/praktike

1. Moduli “Bazat e dizenjimit të brendshëm”

Kualifikimi: Dizënjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme
Niveli: V i KSHK
Viti: I

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	BAZAT E DIZENJIMIT TË BRENDSHËM	M-02-2335-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh me bazat teorike dhe praktike të dizenjimit të brendshëm. Nxënësit njohin elementët bazë të kompozimit, parimet e dizajnit, si dhe aftësohen për të zhvilluar një projekt duke nisur nga idea e deri në realizim.	
Kohëzgjatja e modulit	120 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit kanë përfunduar të paktën një kualifikim profesional të nivelit IV në KSHK në drejtimet Ndërtim ose Arte të bukura/ose kanë përfunduar arsimin e përgjithshëm në nivelin IV në KSHK dhe kanë të paktën një vit përvojë pune, të vërtetuar, në fushat Ndërtim ose Arte të bukura.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi përshkruan konceptin, rolin dhe aplikimet e dizenjimit të brendshëm në funksion të ambientit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të shpjegojë çfarë është dizajni i brendshëm dhe si lidhet me nevojat e përdoruesve; – të përkufizojë objektivat kryesore të dizajnit të brendshëm: funksionaliteti, estetika, komoditeti dhe identiteti vizual; – të listojë lloje të ndryshme hapësirash ku aplikohet dizajni i brendshëm (rezidenciale, komerciale, publike etj.); – të identifikojë profesionet e lidhura me dizajnin e brendshëm dhe ndërveprimin e tyre në projekt (dizenjator, arkitekt, marangoz, ndriçues etj.); – të analizojë rolin e dizajnit në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe përdorshmërisë së hapësirave. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Vëzhgim me listë kontrolli. – Test për aspektet teorike. RN 2 Nxënësi analizon elementët vizualë dhe hapësinor që përbëjnë dizajnin e brendshëm. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të emërtojë elementët përbërës: linja, forma, ngjyra, drita, tekstura, përmasa, hapësira; – të përshkruajë funksionin e secilit element dhe efektin që ka në ndjesinë hapësinore;	

- të dallojë elementët vizualë nga ata funksionalë dhe rolin që luajnë në dizajn;
- të japë shembuj konkretë për secilin element në hapësira reale;
- të përshkruajë ndikimin psikologjik dhe vizual të elementëve në përdoruesit e një hapësire.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 3 Nxënësi propozon zgjidhje krijuese për organizimin dhe transformimin e një hapësire të brendshme.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të vlerësojë gjendjen ekzistuese të një hapësire për përmirësim funksional dhe estetik;
- të zhvillojë ide konceptuale për ridizenjimin e hapësirës përmes skicave, planeve ose vizatimeve ilustrative;
- të integrojë në mënyrë të duhur elementët përbërës të dizajnit të brendshëm si forma, ngjyra, ndriçimi dhe materialet;
- të krijojë një prezantim vizual të qartë të propozimit përmes moodboard-it, përshkrimit të konceptit dhe kompozimit të planit;
- të argumentojë idetë dhe vendimet e marra në bazë të analizës së nevojave të përdoruesit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në shkollë dhe në objekte reale duke përdorur raste reale projekti të një hapësire të njohur nga nxënësi (shtëpi, dhomë, klasë, lokal etj.) për t'i dhënë kuptim konkret zbatimit të njohurive teorike.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet dhe argumentimet konkrete të aspekteve që lidhen me bazat e dizajnit të brendshëm
- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë shembuj konkret projektimi të hapësirave të ndryshme .
- Mësimdhënësi duhet të përdorë simulime për praktikimin e nxënësve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari dhe situata konkrete pune bazuar te udhëzuesi i përmbushjes së aftësisë, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.

	– Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për aftësimin e nxënësve në dizajnimin e hapësirave të brendshme. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësve.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore. - Ambient pune i pajisur me tavolina pune për skicim - Mjete për vizatim (lapsa, pengesa, bojëra, ngjyra, letër teknike) - Tabela për prezantim vizual ose kompjuter për modelim 2D - Shembuj të stileve të dizajnit të brendshëm për ilustrim - Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

2. Moduli “Stilet në dizenjim dhe dekorim”

Kualifikimi: Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme
Niveli: V i KSHK
Viti: I

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe Kodi	STILET NË DIZENJIM DHE DEKORIM	M-02-2336-25
Qëllimi i modulit	Një modul që synon t’i pajisë nxënësit me njohuri mbi stilet kryesore historike dhe bashkëkohore të dizenjimit dhe dekorimit të ambienteve të brendshme, si dhe i aftëson ata për të analizuar karakteristikat estetike, funksionale dhe kulturore të secilit stil, si dhe në zbatimin praktik të njohurive në projektimin e hapësirave.	
Kohëzgjatja e modulit	120 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit kanë përfunduar të paktën një kualifikim profesional të nivelit IV në KSHK në drejtimet Ndërtim ose Arte të bukura/ose kanë përfunduar arsimin e përgjithshëm në nivelin IV në KSHK dhe kanë të paktën një vit përvojë pune, të vërtetuar, në fushat Ndërtim ose Arte të bukura.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi identifikon periudhat historike dhe stilet përkatëse të dizajnit të brendshëm. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përshkruajë në mënyrë të saktë periudhat kryesore të historisë së dizajnit të brendshëm: klasik, barok, modern, post-modern etj.; – të identifikojë karakteristikat kryesore të secilit stil (format, ngjyrat, materialet, motivet dekorative, ndriçimi, përdorimi i hapësirës); – të shpjegojë ndikimin e kontekstit social dhe kulturor në zhvillimin e stileve të ndryshme; – të dallojë tiparet dalluese ndërmjet stileve nëpërmjet analizës së imazheve dhe hapësirave ekzistuese; – të përgatitë një portofol vizual që paraqet elementët thelbësorë të stileve të studiuara.. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Vëzhgim me listë kontrolli. – Test për aspektet teorike.
	RN 2	Nxënësi analizon veçoritë funksionale dhe estetike të stileve të dizajnit të brendshëm. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë përdorimin e ngjyrave, formave, ndriçimit dhe teksturave në çdo stil;
- të shpjegojë marrëdhënien mes funksionalitetit dhe estetikës në hapësirat e stilizuara;
- të krahasojë dy stile në aspektin e përputhshmërisë me nevojat e përdoruesit, funksionit të hapësirës dhe kohës së zbatimit;
- të realizojë një projekt të vogël (ide ose skicë) mbi një hapësirë të brendshme me një stil të zgjedhur, duke justifikuar zgjedhjet dizajnuese;
- të vlerësojë ndikimin e secilit stil në atmosferën e përgjithshme të një ambienti.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 3 Nxënësi zhvillon një koncept të thjeshtë dizajni për një hapësirë të caktuar.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të krijojë një skicë fillestare (vizatim me dorë të lirë ose digjitale) për dizajnin e një hapësire funksionale;
- të paraqesë shpërndarjen bazë të elementëve në hapësirë duke respektuar rregullat e kompozimit;
- të zgjedhë duke argumentuar, përdorimin e ngjyrave, dritës, teksturave dhe elementëve bazë;
- të përpilojë një paraqitje vizuale të konceptit të vet (plan, përshkrim, referenca vizuale ose moodboard);
- të analizojë dizajnin e vet dhe të japë arsyeime për zgjedhjet e bëra.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në shkollë dhe në objekte reale për t'i dhënë kuptim konkret zbatimit të njohurive teorike.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet dhe argumentimet konkrete të aspekteve që lidhen me stilet e dizajnit dhe dekorimit.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë shembuj konkret të stileve të dizajnit dhe dekorimit.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë shembuj për krijimin e kolazheve, analizë hapësirash, realizimin e skicimeve të thjeshta dhe përgatitjen e prezantimeve.
- Mësimdhënësi duhet të nxisë nxënësit në kërkimin individual për stile të ndryshme dhe shprehjen personale përmes vizualizimeve.

-
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari dhe situata konkrete pune bazuar te udhëzuesi i përmbushjes së aftësisë, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për aftësimin e nxënësve në krijimin e stileve të ndryshme të dizajnit dhe dekorimit.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të nxënësve.
-

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë e pajisur me projektor dhe ekran për prezantime vizuale;
- Lidhje interneti për kërkime stilistike dhe burime referimi;
- Bordi i bardhë për skicime;
- Furnizime për punime manuale (fletë, ngjyra, vizore, gërrshërë, ngjitës etj.);
- Galeri stilesh (foto, mostra, libra referencash);
- Hapësirë për punë individuale dhe diskutime në grup.
- Shembuj të stileve të dizajnit të brendshëm për ilustrim
- Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

3. Moduli “Gjeometri deskriptive”

Kualifikimi: Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme
 Niveli: V i KSHK
 Viti: I

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	GJEOMETRI DESKRIPTIVE	M-02-2337-25
Qëllimi i modulit	Ky modul synon të pajisë nxënësit me njohuri bazë dhe aftësi praktike në përfaqësimin vizual të objekteve tredimensionale nëpërmjet metodave të gjeometrisë deskriptive. Ai u jep nxënësve mjetet për të kuptuar figura gjeometrike në hapësirë, të aplikueshme në dizajn të brendshëm.	
Kohëzgjatja e modulit	120 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit kanë përfunduar të paktën një kualifikim profesional të nivelit IV në KSHK në drejtimet Ndërtim, artit aplikativ, ose arsimit të përgjithshëm dhe kanë interes në dizajn / ose kanë përfunduar arsimin e përgjithshëm në nivelin IV në KSHK dhe kanë të paktën një vit përvojë pune, të vërtetuar, në fushat e mësipërme.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi përshkruan bazat teorike të gjeometrisë deskriptive në dizajn. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përkufizojë çfarë është gjeometria deskriptive dhe qëllimi i saj; – të shpjegojë aplikimet e saj në fushat teknike dhe të dizajnit; – të identifikojë llojet e projeksioneve dhe përdorimin e tyre; – të identifikojë dallimin ndërmjet vizatimit artistik dhe atij teknik në funksionin e tyre; – të tregojë me shembuj përdorimin e gjeometrisë deskriptive në projekte konkrete arkitektonike apo teknike; – të shpjegojë terminologjinë teknike të përdorur në përshkrimin e formave dhe pozicioneve në hapësirë. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Vëzhgim me listë kontrolli. – Test për aspektet teorike.
	RN 2	Nxënësi ndërton vizatime në projeksione ortogonale. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të vizatojë pamjet ortogonale të objekteve të thjeshta (pamje nga lart, ballore, anësore);

- të shpjegojë marrëdhënien ndërmjet pamjeve dhe objektit tredimensional;
- të aplikojë rregullat e renditjes dhe shkallës në vizatim teknik;
- të identifikojë objektet që përfaqësohen në secilën pamje të projeksionit ortogonal;
- të aplikojë teknikën e përputhjes së pamjeve për të interpretuar dhe verifikuar saktësinë e vizatimit;
- të demonstrojë aftësi për të kaluar nga një përfaqësim tridimensional në një vizatim në dy dimensione (rrafshimi i formës).

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 3 Nxënësi zbaton rregullat e vizatimit teknik.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të paraqesë objekte në dy dhe tre pamje sipas metodës së përcaktuar;
- të përdorë simbole, vijëzim dhe përmasa sipas standardeve teknike;
- të realizojë vizatime me saktësi, pastërti dhe qartësi grafike;
- të përzgjedhë llojin e vijave sipas standardeve (vija të plota, të ndërprera, ndihmëse);
- të realizojë sistemin e vendosjes së pamjeve;
- të përdorë përmasat në mënyrë të saktë dhe të lexueshme sipas normave teknike;
- të dallojë gabime në vendosjen e pamjeve ose në renditjen e tyre.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 4 Nxënësi realizon figura gjeometrike në hapësirë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të ndërtojë figura të thjeshta gjeometrike (prizma, piramida, cilindër etj.);
- të zgjidhë probleme ndërprerjeje dhe prerjeje midis formave;
- të përdorë metoda grafike për përfaqësim hapësinor të objekteve;

- të paraqesë me saktësi ndërprerjen dhe prerjen e dy trupave në hapësirë;
- të përdorë metoda grafike për ndërtimin e hijes ose ndriçimit të thjeshtë të objekteve;
- të vizatojë pozicionime relative midis objekteve paralelizëm, pjerrësi, prerje të pjerrëta;
- të zbatojë rregulla të thjeshta për zhvillimin e sipërfaqeve anësore të trupave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul mund të realizohet në klasë për mësimin teorik dhe laborator për me ushtrime.

- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe konkretizime të gjeometrisë deskriptive.
- Nxënësit duhet të nxiten të zbatojnë sa më shumë veprimtari konkrete dhe detyra praktike për interpretimin e vizatimeve në gjeometrinë deskriptive. Ata duhet të angazhohen në bashkëbisedime profesionale në lidhje me çështjet që trajtohen në modul.
- Mësimdhënësit duhet të përdorin sa më shumë të jetë e mundur mjetet dhe pajisjet e duhura në shërbim të modulit gjeometria deskriptive.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të vlerësimit të specifikuar për çdo rezultat të nxënësit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore dhe kabinet i kompjuterave me lidhje interneti, si dhe me printera.
- Materiale kancelarie.
- Mjetet, veglat dhe pajisjet e vizatimit teknik.
- Projekte, skema, bllok-skema dhe skica për vizatimet teknike.
- Materiale të shkruara në mbështetje të modulit.

4. Moduli “Vizatimi teknik dhe digjital”

Kualifikimi: Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme
Niveli: V i KSHK
Viti: I

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	VIZATIMI TEKNIK DHE DIGJITAL	M-01-2338-25
Qëllimi i modulit	Ky modul i pajis nxënësit me aftësi teknike dhe digjitale në fushën e vizatimit të projekteve të dizajnit të brendshëm, duke kombinuar teknikat manuale me ato të softuerëve profesionalë, si dhe për të përfaqësuar objekte, hapësira dhe ide në mënyrë të saktë, funksionale dhe vizualisht të kuptueshme. Moduli kontribuon në ndërtimin e të menduarit teknik dhe përdorimit praktik të mjeteve të vizatimit në funksion të komunikimit profesional dhe përgatitjes së projekteve reale.	
Kohëzgjatja e modulit	180 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit kanë përfunduar të paktën një kualifikim profesional të nivelit IV në KSHK në drejtimet Ndërtim ose Arte të bukura/ose kanë përfunduar arsimin e përgjithshëm në nivelin IV në KSHK dhe kanë të paktën një vit përvojë pune, të vërtetuar, në fushat Ndërtim ose Arte të bukura.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi përdor mjete dhe teknikat e vizatimit teknik. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të identifikojë dhe përdorë në mënyrë të saktë instrumentet tradicionale të vizatimit teknik (vizore, trekëndësja, kompas etj.); – të aplikojë teknika të vijëzimit sipas standardeve teknike; – të aplikojë teknika të hijëzimit sipas standardeve teknike; – të aplikojë teknika të përmasimit sipas standardeve teknike; – të vizatojë figura gjeometrike për përfaqësimin e formave, objekteve dhe hapësirave; – të ruajë pastërtinë dhe organizimin në paraqitjen grafike; – të interpretojë vizatime teknike të dhëna. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Vëzhgim me listë kontrolli. – Test për aspektet teorike. RN 2 Nxënësi realizon vizatime teknike me softuerë të specializuar. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:	

- të përdorë komandat bazë dhe ndërfaqen e softuerit të vizatimit;
- të krijojë vizatime në dy dimensione (2D) duke respektuar përmasat dhe standardet;
- të menaxhojë shtresat (layers), llojet e vijave dhe formatet e vizatimit;
- të aplikojë përmasa, etiketa dhe simbolikë në mënyrë korrekte;
- të ruajë dhe eksportojë skedarë në formatet e nevojshme.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 3 Nxënësi realizon paraqitje vizuale për ndërtimin e skemave ose planeve funksionale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të rendisë hapat për krijimin e një projekti teknik digjital;
- të përgatisë planimetri të thjeshta për hapësira të brendshme duke respektuar funksionin dhe përmasat reale;
- të përdorë simbole për mobilim, ndriçim dhe instalime të thjeshta sipas standardeve të projektimit;
- të analizojë shpërndarjen hapësinore dhe funksionalitetin e planit;
- të prezantojë projektin në mënyrë të kuptueshme dhe profesionale;
- të përdorë referenca vizuale për komunikim koncepti.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 4 Nxënësi korrigjon gabime teknike dhe grafike në vizatime manuale dhe digjitale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë pasaktësi në përmasim, ndarje apo përfaqësim të elementeve grafike;
- të krahasojë vizatimet manuale dhe digjitale për saktësi, lexueshmëri dhe efikasitet;
- të aplikojë korrigjime për të përmirësuar qartësinë dhe standardin teknik të projektit;
- të argumentojë ndryshimet e bëra mbi gabimet e identifikuar;
- të ndjekë udhëzime teknike për përmirësim të produktit përfundimtar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

Udhëzime për zbatimin e modulit	Ky modul realizohet duke integruar pjesën teorike dhe praktike në klasë dhe laborator kompjuterik. - Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe konkretizime të vizatimeve me dorë dhe digjitale. - Nxënësit duhet të nxiten të zbatojnë sa më shumë veprimtari konkrete dhe detyra praktike për të realizuar vizatime teknike me dorë dhe në rrugë digjitale. Ata duhet të angazhohen në bashkëbisedime profesionale në lidhje me çështjet që trajtohen në modul. - Mësimdhënësit duhet të përdorin sa më shumë të jetë e mundur mjetet dhe pajisjet e duhura për realizimin e vizatimit teknik dhe digjital. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të vlerësimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Mjete për vizatim teknik (vizore, trekëndësja, letra teknike, etj.); - Kompjutera me softuer vizatimi; - Printer A3/A4 për printimin fizik të projekteve; - Tabela prezantimi ose ekran për demonstrim të proceseve digjitale; - Shembuj projektesh model për referencë dhe analizë. - Manual përdorimi të programeve softuerike, - Materiale kancelarie. - Projekte, skema, bllok-skema dhe skica. - Manuale dhe formate të dokumentacionit teknik që përdoren në sektorin e dizenjimit të ambjenteve të brendshme. - Materiale të shkruara në mbështetje të modulit.

5. Moduli “Ngjyrat dhe ndriçimi në hapësirë”

Kualifikimi: Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme
Niveli: V i KSHK
Viti: I

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	NGJYRAT DHE NDRIÇIMI NË HAPËSIRË	M-02-2339-25
Qëllimi i modulit	Një modul që synon t’i pajisë nxënësit me njohuri dhe aftësi për përdorimin efektiv të ngjyrave dhe ndriçimit në projektimin e ambienteve të brendshme, duke theksuar rëndësinë e perceptimit vizual, harmonisë kromatike dhe ndikimit të ndriçimit natyral dhe artificial në kompozimin estetik dhe funksional të hapësirës.	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një kualifikim profesional të nivelit IV të KSHK në drejtimin Ndërtim ose Arte të Bukura, ose të kenë përfunduar arsimin e përgjithshëm në nivelin IV dhe të kenë të paktën një vit përvojë pune të dokumentuar në këto fusha.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi përshkruan teorinë dhe përdorimin e ngjyrave në dizajnin e hapësirës së brendshme. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të shpjegojë kuptimin e teorisë së ngjyrave; – të identifikojë marrëdhëniet midis ngjyrave (kontrasti, harmonia, temperatura e ngjyrës); – të përshkruajë spektrin e ngjyrave (tonaliteti, saturimi, drita); – të përshkruajë psikologjinë e ngjyrës dhe ndikimin në perceptimin e hapësirës; – të japë shembuj të përdorimit të ngjyrave sipas funksionit të ambienteve; – të analizojë shembuj konkretë të paletave të ngjyrave për ambiente banimi dhe komerciale; – të shpjegojë përdorimin e ngjyrave për të theksuar, korrigjuar ose organizuar vizualisht hapësirën. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Vëzhgim me listë kontrolli. – Test për aspektet teorike. RN 2 Nxënësi zbaton teknikat e ndriçimit në dizajnin e brendshëm. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:	

- të shpjegojë llojet e ndriçimit (natyral, artificial, i drejtpërdrejtë, i tërthortë);
- të analizojë ndikimin e ndriçimit në perceptimin e ngjyrës dhe formës;
- të krahasojë ndriçimit funksional me atë dekorativ;
- të identifikojë pajisjet ndriçuese dhe pozicionimin e tyre në hapësirë;
- të përshkruajë konceptin e temperaturës së dritës (Kelvin) dhe rendimentit të ngjyrave (CRI);
- të projektojë ndriçimin për një hapësirë banimi, komerciale etj.;
- të propozojë zgjidhje ndriçimi në funksion të estetikës dhe komoditetit;
- të respektojë standardet për efikasitet energjetik dhe ndriçim të qëndrueshëm.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të zhvillohet në klasë mësimore të pajisur me mjetet bazë vizuale (projektor, panele ngjyrash, mostra ndriçimi), ndërsa pjesa praktike e modulit të realizohet në laborator dizajni ose hapësirë pune ku nxënësit të ushtrohen me mostra ngjyrash, lloje ndriçimi dhe simulime ndriçimi.

- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe konkretizime të përdorimit të ngjyrave dhe ndriçimit në hapësirë.
- Nxënësit duhet të nxiten të zbatojnë sa më shumë veprimtari konkrete dhe detyra praktike për të realizuar përdorimin e ngjyrave dhe të ndriçimit në hapësirë. Ata duhet të angazhohen në bashkëbisedime profesionale në lidhje me çështjet që trajtohen në modul.
- Mësimdhënësit duhet të përdorin sa më shumë të jetë e mundur mjetet dhe pajisjet e duhura për realizimin e ngjyrave dhe ndriçimit në hapësirë.
- Mësimdhënësi mund të organizojë vizita në showroom-e ndriçimi, ambiente të brendshme të realizuara profesionalisht dhe bashkëpunime me profesionistë të fushës.
- Nxënësit inkurajohen të realizojnë një projekt të thjeshtë për dizajnin kromatik dhe ndriçimin e një hapësire të vogël (dhomë ndenjeje, zyrë, dyqan).
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të vlerësimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Materiale të shkruara në mbështetje të modulit
- Pajisje ndriçimi (LED, halogjen, llamba fluoreshente, etj.)
- Paleta ngjyrash dhe mostra materiale
- Pajisje për vizatim dhe skicim
- Mjete për prezantim digjital

-
- Hapësirë e dedikuar për punë praktike (laborator dizajni).
 - Manuale dhe formate të dokumentacionit teknik që përdoren në sektorin e dizenjimit të ambjenteve të brendshme.
 - Materiale të shkruara në mbështetje të modulit.

6. Moduli “Projektimi dhe dekorimi i hapësirave të brendshme -1”

Kualifikimi: Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme
Niveli: V i KSHK
Viti: I

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PROJEKTIMI DHE DEKORIMI I HAPËSIRAVE TË BRENDSHME - 1	M-02-2340-25
Qëllimi i modulit	Ky modul i pajis nxënësit me njohuritë themelore mbi kompozimin, organizimin e hapësirës dhe përfaqësimin vizual të hapësirave të brendshme, si dhe i aftëson për interpretimin e hapësirave në funksion të nevojave të përditshme dhe transformimin e tyre në ambiente estetike, të rehatshme dhe funksionale.	
Kohëzgjatja e modulit	150 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit kanë përfunduar të paktën një kualifikim profesional të nivelit IV në KSHK në drejtimet Ndërtim ose Arte të bukura/ose kanë përfunduar arsimin e përgjithshëm në nivelin IV në KSHK dhe kanë të paktën një vit përvojë pune, të vërtetuar, në fushat Ndërtim ose Arte të bukura.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi përshkruan konceptet themelore të dizajnit të brendshëm. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të shpjegojë qartë konceptin e dizajnit të brendshëm. – të identifikojë funksionet kryesore të dizajnit të brendshëm (estetike, funksionale, ergonomike dhe emocionale). – të analizojë ndikimin që ka dizajni i brendshëm në mirëqenien fizike dhe psikologjike të përdoruesve. – të përshkruajë rolin e dizajnit të brendshëm në formësimin e përvojës së përditshme të individit në ambiente të ndryshme (shtëpi, shkollë, zyrë etj). – të vlerësojë marrëdhënien ndërmjet dizajnit dhe nevojave sociale, kulturore dhe ekonomike të përdoruesit. – të përshkruajë tipologjitë kryesore të hapësirave të brendshme: rezidenciale, komerciale, institucionale, rekreative etj. – të dallojë ndryshimet dhe kërkesat specifike të secilës tipologji hapësinore në raport me përdoruesin dhe funksionin. – të përshkruajë rolin e profesionistëve të ndryshëm në procesin e dizajnit të brendshëm: dizajner i brendshëm, arkitekt, inxhinier, ndërtues, dekorator etj.	

- të vlerësojë procesin bashkëpunues midis profesionistëve të fushave të ndryshme për të arritur një zgjidhje të suksesshme dizajni.
- të reflektojë mbi rëndësinë e analizës së kontekstit dhe përdoruesit para fillimit të një projekti dizajni.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 2 Nxënësi analizon elementët vizualë dhe të hapësirës në dizajn.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë elementët bazë vizualë në dizajnin e brendshëm: linja, forma, ngjyra, tekstura, drita dhe hapësira;
- të analizojë funksionin e linjave (vertikale, horizontale, diagonale, të lakuara) në krijimin e strukturës dhe orientimit vizual në hapësirë;
- të përshkruajë ndikimin e formave (organike dhe gjeometrike) në karakterin dhe atmosferën e një ambienti;
- të vlerësojë përdorimin e ngjyrës në krijimin e emocioneve, kontrasteve dhe harmonisë vizuale; kupton psikologjinë e ngjyrave.
- të shpjegojë rolin e teksturës (të dukshme dhe të ndjeshme) në pasurimin vizual dhe taktil të sipërfaqeve të brendshme.
- të përshkruajë rëndësinë e dritës (natyrale dhe artificiale) në funksionalitetin dhe estetikën e hapësirës.
- të analizojë mënyrat se si hapësira strukturohet dhe perceptohet nëpërmjet organizimit, përmasave dhe rrjedhshmërisë së saj.
- të japë shembuj konkretë të përdorimit të secilit element në kontekste të ndryshme të dizajnit të brendshëm (p.sh. zyrë, dhomë gjumi, hapësirë publike).
- të analizojë ndikimin psikologjik të elementëve vizualë të përdoruesit: ndjesi qetësie, energjie, sigurie, ngrohtësie etj.
- të vlerësojë balancën dhe harmoninë ndërmjet elementëve vizualë në krijimin e një ambienti funksional dhe estetik.
- të analizojë përzgjedhjen e materialeve dhe ngjyrave në raport me përdoruesin dhe funksionin e hapësirës.
- të përshkruajë ndikimin kulturor dhe social të elementëve vizualë në dizajn.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 3 Nxënësi shpjegon parimet e organizimit dhe kompozimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë balancën si shpërndarje e barabartë vizuale e elementëve në hapësirë (balancë simetrike, asimetrike dhe radiale).
- të shpjegojë konceptin e ritmit në dizajn si përsëritje ose ndryshim i rregullt i elementëve që udhëheqin syrin përmes hapësirës.
- të përshkruajë unitetin, koherencën dhe lidhjen midis të gjitha pjesëve të një dizajni.
- të përshkruajë kontrastin si përdorim i elementëve të kundërt (si dritë/hije, ngjyrë/teksturë, formë/madhësi) për të krijuar interes vizual dhe theksim.
- të analizojë theksimin (fokusin vizual) si teknikë për të drejtuar vëmendjen te një element i rëndësishëm në hapësirë.
- të zbatojë parimin e proporcionit dhe shkallës për të krijuar marrëdhënie të përshtatshme midis elementëve dhe përdoruesit.
- të vlerësojë harmoninë si kombinim i suksesshëm i elementëve që përputhen natyrshëm pa qenë monotonë.
- të zbatojë parimet e projektimit dhe dekorimit të hapësirave ekzistuese (në klasë, në shtëpi, ambiente publike etj.) duke identifikuar si janë përdorur.
- të hartojë projekte të vogla dizajni ose skica kompozimi që pasqyrojnë përdorimin e një ose më shumë parimeve të projektimit dhe dekorimit.
- të demonstrojë vendosjen e objekteve në një hapësirë për të kuptuar efektin e ndryshimeve në balancë dhe kompozim.
- të analizojë punime dizajni (foto, ilustrime, ambiente të modeluara) për të identifikuar zbatimin e parimeve të kompozimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 4 Nxënësi zbaton njohuritë bazë në zhvillimin e konceptit të dizajnit të brendshëm.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë procesin e zhvillimit të një koncepti si bazë krijuese për projektin e dizajnit të brendshëm.
- të hartojë një koncept të thjeshtë, duke u bazuar në kërkesat funksionale, emocionet që do të përcjellë dhe kualifikimin e përdoruesit.
- të krijojë moodboard-e për të shprehur vizualisht atmosferën, stilin, ngjyrat dhe materialet e përzgjedhura për projektin.
- të realizojë skica fillestare të hapësirave që pasqyrojnë idenë dhe rrjedhën e konceptit të zgjedhur.
- të analizojë nevojat e përdoruesit dhe i përfshin ato në zhvillimin e konceptit (për shembull: funksionalitet, aksesueshmëri, komoditet).

- të zgjedhë me kujdes materialet, ngjyrat dhe teksturat që përputhen me funksionin dhe ndjesinë që synon të transmetojë dizajni.
- të argumentojë përzgjedhjet estetike dhe teknike.
- të përdorë referenca vizuale (fotografi, revista, internet etj.) për të mbështetur zhvillimin e konceptit.
- të përdorë forma të ndryshme prezantimi për të komunikuar idetë: skica të dorës, kolazh, përshkrime tekstuale, digjitale apo fizike.
- të analizojë pikat e forta dhe të dobëta të konceptit të zhvilluar dhe ofron përmirësime të mundshme.
- të demonstrojë lidhjen ndërmjet konceptit dhe zgjidhjes finale të hapësirës (p.sh. si koncepti pasqyrohet në zgjedhjen e mobilieve, ndriçimit, ngjyrave).
- të realizojë punë individuale dhe/ose në grup për të zhvilluar ide të ndryshme dhe për të përfutur nga reflektimi kolektiv.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të zhvillohet në klasë mësimore të pajisur me mjetet bazë vizuale si: tavolina pune dhe mjete vizatimi për të realizuar projektim dhe dekorim të hapësirave të brendshme.

- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe konkretizime të projektimit dhe dekorimit të hapësirave të brendshme.
- Nxënësit duhet të nxiten të zbatojnë sa më shumë veprimtari konkrete dhe detyra praktike për të realizuar projektimin dhe dekorimin e hapësirave të brendshme. Ata duhet të angazhohen në bashkëbisedime profesionale në lidhje me çështjet që trajtohen në modul.
- Mësimdhënësit duhet të përdorin sa më shumë të jetë e mundur mjetet dhe pajisjet e duhura për realizimin e projektimit dhe dekorimit të hapësirave të brendshme.
- Mësimdhënësi mund të organizojë vizita mësimore në studio projektimi dhe dekorimi të hapësirave të brendshme.
- Nxënësit inkurajohen të realizojnë një projekt të thjeshtë për projektimin dhe dekorimin e një hapësire të caktuar.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të vlerësimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mesimore e pajisur me tavolina projektimi.
- Mjetet e vizatimit për projektim.
- Mostra materiali dhe katalogë ngjyrash.
- Projektor, printer për prezantime.
- Bordi i bardhë për skicime;

-
- Furnizime për punime manuale (fletë, ngjyra, vizore, gërshërë, ngjitës etj.);
 - Galeri stileshe (foto, mostra, libra referencash)
 - Hapësirë e dedikuar për punë praktike (laborator dizajni).
 - Manuale dhe formate të dokumentacionit teknik që përdoren në sektorin e dizajnit të ambjenteve të brendshme.
 - Materiale të shkruara në mbështetje të modulit.

7. Moduli “Standardet e projektimit dhe organizimi i hapësirës-1”

Kualifikimi: Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme
Niveli: V i KSHK
Viti: I

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	STANDEDET E PROJEKTIMIT DHE ORGANIZIMI I HAPËSIRËS -1	M-02-2341-25
Qëllimi i modulit	Ky modul ka për qëllim të pajisë nxënësit me njohuri themelore mbi standardet teknike dhe ergonomike të projektimit, rregullat funksionale të organizimit të hapësirës së brendshme, si dhe i aftëson ata të lexojnë dhe zbatojnë standardet e projektimit (si përmasa minimale, lartësi, largësi funksionale), të aplikueshme në hapësira rezidenciale dhe komerciale dhe të organizojnë në mënyrë efikase hapësira të brendshme në raport me funksionin, lëvizshmërinë, dritën natyrale dhe kërkesat e përdoruesit.	
Kohëzgjatja e modulit	120 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit kanë përfunduar të paktën një kualifikim profesional të nivelit IV në KSHK në drejtimet Ndërtim, artit aplikativ, ose arsimit të përgjithshëm dhe kanë interes në dizajn / ose kanë përfunduar arsimin e përgjithshëm në nivelin IV në KSHK dhe kanë të paktën një vit përvojë pune, të vërtetuar, në fushat e mësipërme.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi përshkruan standardet funksionale dhe dimensionale të projektimit të hapësirave të brendshme. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përshkruajë përmasat standarde për elementët bazë të ambienteve (dyscheme, tavane, dritare, dyer, korridore, mobilie); – të identifikojë distancat funksionale midis objekteve dhe zonave të përdorimit; – të dallojë shenja konvencionale të instalimeve (elektrike, furnizime uji, kanalizim, ngrohje-ftoje-ventilim, gaz etj.) të përdorura në një objekt të thjeshtë. – të lexojë skemat teknike dhe të interpretojë të dhënat standarde nga manuale profesionale; – të krahasojë standardet ergonomike në ambiente të ndryshme (banim, punë, shërbim); – të vlerësojë rëndësinë e respektimit të standardeve për funksionalitetin dhe komoditetin. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Vëzhgim me listë kontrolli.	

-
- Test për aspektet teorike..

RN 2 Nxënësi organizon në mënyrë funksionale një hapësirë të brendshme.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hartojë shpërndarjen e zonave në një plan hapësinor (hyrje, qëndrim, punë, ruajtje etj.);
- të vendosë elementët përbërës në përputhje me fluksin e lëvizjes dhe ergonominë;
- të aplikojë përmasa dhe distanca të sakta sipas standardeve në planimetri;
- të analizojë përdorimin efektiv të hapësirës në funksion të qëllimit dhe kontekstit;
- të paraqesë vizualisht zgjidhjen hapësinore me mjete teknike (2D/3D, manuale ose digjitale).

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike..

RN 3 Nxënësi përshtat standardet e projektimit për kategori të ndryshme përdoruesish.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë kërkesa të veçanta ergonomike për grupe specifike (fëmijë, të moshuar, persona me aftësi të kufizuara);
- të zbatojë rregullat e aksesueshmërisë (akses me karrocë, nivele, dritare të ulëta, doreza etj.);
- të bëjë modifikime në plan për të përfshirë zgjidhje gjithëpërfshirëse (universal design);
- të vlerësojë ndikimin e përmasave jo-standard në përdorshmërinë e hapësirës;
- të bashkëpunojë me etikë profesionale me të gjithë përfshirësit në projekt.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të zhvillohet në klasë dhe në studio projektimi për pjesën praktike. .

- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe konkretizime të standardeve të projektimit dhe të organizimit të hapësirave.
- Nxënësit duhet të nxiten të zbatojnë sa më shumë veprimtari konkrete dhe detyra praktike për të zbatuar standardet e projektimit dhe organizmin e hapësirave. Ata duhet të angazhohen në bashkëbisedime profesionale në lidhje me çështjet që trajtohen

	në modul. - Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur mjetet dhe pajisjet e duhura për zbatimin e standardeve të projektimit dhe organizimin e hapësirave. - Mësimdhënësi mund të organizojë vizita mësimore në studio projektimi dhe dekorimi të hapësirave të brendshme. - Nxënësit inkurajohen të realizojnë një projekt të thjeshtë për projektimin dhe dekorimin e një hapësire të caktuar, duke zbatuar standardet e duhura. Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të vlerësimit të specifikuar për çdo rezultat të nxënësit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore dhe kabinet i kompjuterave me lidhje interneti, Klasë e pajisur me tavolina pune të përshtatshme për vizatim teknik dhe diskutim në grup; - Tabela dhe projektor për paraqitje grafike të standardeve dhe planimetri; - Ambient laboratorik (nëse i disponueshëm) për simulime të zgjidhjeve hapësinore në shkallë të vogël. - Lapsa teknikë, letra milimetrike, letër vizatimi, linjarë, trekëndësja dhe mjete për matje të saktë; - Skema model, plane teknike dhe fletë pune të strukturuar për punë individuale dhe në grup.

8. Moduli “Projektimi dhe dekorimi i hapësirave të brendshme - 2”

Kualifikimi: Dizënjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme
Niveli: V i KSHK
Viti: II

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PROJEKTIMI DHE DEKORIMI I HAPËSIRAVE TË BRENDSHME -2	M-02-2342-25
Qëllimi i modulit	Ky modul synon pajisjen e nxënësve me njohuri të avancuara në fushën e dizajnit të brendshëm, duke thelluar konceptet e dizajnit, zhvillimin e projekteve më komplekse dhe aplikimin praktik të parimeve estetike dhe funksionale në ambientet reale, si dhe i aftëson ata që të krijojnë projekte të dizajnit të brendshëm me argumentim profesional, duke integruar aspektet estetike, teknike dhe ergonomike, si dhe të përdorin mjete vizuale dhe digjitale për prezantimin e ideve.	
Kohëzgjatja e modulit	150 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit kanë përfunduar modulet profesionale të vitit I të kualifikimit profesional “Dizënjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme” Niveli V i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi identifikon konceptin e avancuar dhe funksionin e dizajnit të brendshëm. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të argumentojë në mënyrë të thelluar, rëndësinë e dizajnit të brendshëm si një element kyç në përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe efikasitetit në punë, duke përfshirë ambiente rezidenciale, komerciale, institucionale dhe rekreative. – të analizojë ndikimet psikologjike (ndjesi, emocione, motivim), ergonomike (pozicionim, komoditet, shëndet), dhe funksionale (prakticitet, qarkullim, siguri) që ka dizajni i brendshëm në përvojën e përdoruesve. – të argumentojë në mënyrë kritike rolin ndërdisiplinor dhe bashkëpunimin mes arkitektëve, inxhinierëve, dizajnerëve të brendshëm, dekoratorëve dhe profesionistëve të tjerë në procesin e zhvillimit të projekteve komplekse. – të kryejë analizë të thelluar të nevojave të përdoruesit duke zbatuar metoda të ndryshme kërkimi si intervista, pyetësorë dhe vëzhgime. – të hartojë raporte të detajuara analizash të përdoruesit dhe kontekstit social-kulturor, duke përfshirë rekomandime për zgjidhje dizajni. – të vlerësojë konceptet fillestare të dizajnit duke integruar reflektime mbi qasjet funksionale dhe estetike.

-
- të interpretojë zbatimin e standardeve ergonomike dhe rregullave të sigurisë në projektimin e hapësirave të brendshme.
 - të realizojë prezantime profesionale me mjete të avancuara vizuale dhe digjitale.
 - të analizojë në mënyrë kritike ndikimin e dizajnit të brendshëm (drita, akustika dhe ngrohja) në shëndetin dhe mirëqenien e përdoruesve.
 - të bashkëpunojë në grup për zhvillimin e analizave dhe koncepteve të dizajnit duke praktikuar komunikim efektiv dhe menaxhim të konflikteve kreative.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 2 Nxënësi aplikon elementë të avancuar vizualë dhe të hapësirës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë, me saktësi dhe kreativitet, elementët bazë vizualë të dizajnit të brendshëm: linja (vertikale, horizontale, diagonale, të lakuara), forma (gjeometrike dhe organike), ngjyra, tekstura (të dukshme dhe taktile), drita (natyrore dhe artificiale) dhe hapësira në projekte të ndryshme;
- të realizojë kombinime të avancuara ngjyrash duke integruar psikologjinë e ngjyrave;
- të aplikojë në mënyrë të avancuar tekstura të ndryshme në projektet konkrete praktike;
- të zbatojë teorinë e perceptimit të hapësirës dhe psikologjinë e hapësirës për organizimin funksional dhe estetik të ambienteve të brendshme, bazuar në standardet e projektimit;
- të eksperimentojë zgjidhje kreative dhe funksionale me elemente vizualë për zgjidhje kreative të dizajnit të brendshëm;
- të përdorë teknologji digjitale (softuerë për modelim 3D, vizualizime, prezantime multimediale) për të zhvilluar dhe paraqitur elementët vizualë dhe të hapësirës në projektet e dizajnit të brendshëm;
- të analizojë rolin e dritës artificiale dhe natyrore në hapësira të ndryshme, duke konsideruar efektet psikologjike, funksionale dhe estetike;
- të krijojë ambiente të balancuara, funksionale dhe me estetikë të lartë, duke optimizuar balancën, kontrastin, ritmin, dhe harmoninë midis elementëve vizualë;
- të bashkëpunojë në grupe të vogla për hartimin e projekteve duke ndjekur standardet e projektimit;
- të analizojë shembuj konkretë kombëtar dhe ndërkombëtarë të përdorimit të avancuar të elementëve vizualë dhe të hapësirës në dizajnin e brendshëm;

- të argumentojë përzgjedhjet estetike dhe funksionale në projektimin dhe dekorimin e hapësirave të brendshme.
- të përdorë materiale të ndryshme dhe kombinimin e tyre me ngjyra, tekstura dhe drita, për të krijuar eksperiencë multisensoriale në ambientet e brendshme;
- të zbatojë parimet e kompozimit me njohuritë teknike për të siguruar që elementët vizualë dhe të hapësirës të jenë të qëndrueshëm, praktikë dhe të përshtatshëm për përdoruesit final.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 3 Nxënësi zbaton parimet e avancuara të kompozimit dhe organizimit të hapësirës së brendshme.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zbatojë parimet kryesore të kompozimit: balancën (simetrike, asimetrike dhe radiale), ritmin (përsëritje, alternativë, progresion), kontrastin (dritë /hije, ngjyrë/ teksturë, formë/ madhësi), fokusin (theksimin e elementit kryesor në hapësirë), proporcionin dhe unitetin (koherencën dhe lidhshmërinë e elementëve në projekt);
- të analizojë zgjedhjet kompozicionale në projektet ekzistuese dhe në punime reale nga dizajni i brendshëm, duke identifikuar efektet vizuale dhe funksionale të këtyre zgjedhjeve;
- të analizojë raste studimore në organizimin e objekteve dhe hapësirave mbi perceptimin estetik dhe funksional të ambientit të brendshëm;
- të vizatojë skica të detajuara mbi bazën e rasteve studimore të analizuara;
- të ndërtojë modele tre-dimensionale që pasqyrojnë në mënyrë të qartë dhe precize përdorimin e parimeve të kompozimit dhe organizimit të hapësirës;
- të zbatojë parimet e kompozimit në hartimin e mobiljeve, ndriçimit, teksturave dhe ngjyrave për të krijuar ambiente harmonike dhe funksionale;
- të përshtatë kompozimin e ambientit të brendshëm duke marrë parasysh ergonominë dhe përdorshmërinë e tij;
- të bashkëpunojë në projekte multidisiplinare për të siguruar që organizimi hapësinor reflekton nevojat e përdoruesve dhe qëllimet estetike të projektit;
- të argumentojë mbi zgjedhjet e konteksteve të ndryshme të cilat ndikojnë në aspektet kulturore, sociale dhe psikologjike bazuar në parimet e kompozimit në dizajnin e brendshëm;
- të përdorë mjete digjitale dhe tradicionale për të dokumentuar dhe prezantuar procesin e projektimit që përfshin këto parime;

- të vlerësojë në mënyrë kritike punime të ndryshme dizajni në terma të balancës, harmonisë, ritmit dhe unitetit, duke ofruar rekomandime për përmirësime;
- të demonstrojë me kombinime jo-konvencionale të parimeve për të zhvilluar zgjidhje unike dhe origjinale në dizajnin e brendshëm.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 4 Nxënësi harton projektin konceptual të dizajnit të brendshëm.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë koncept dizajnin, duke përdorur moodboard-e të pasura me elementë vizualë, ngjyra, materiale dhe tekstura që pasqyrojnë frymën dhe stilin e projektit;
- të hartojë skica dhe vizatime fillestare me nivele të ndryshme detajimi, duke përfshirë planimetrinë, perspektivën dhe pamjet e brendshme që ilustrjnë idenë e përgjithshme;
- të kryejë analiza të detajuara për funksionalitetin e hapësirës, duke marrë parasysh qasjen, rrjedhshmërinë, ergonominë dhe përdorshmërinë e elementëve brenda ambientit;
- të vlerësojë aspektet estetike të projektit, duke u fokusuar në harmoninë e ngjyrave, materialeve, ndriçimit dhe kompozimit hapësinor;
- të integrojë në mënyrë efektive kërkesat e përdoruesit, duke analizuar nevojat specifike, preferencat dhe stilin e jetesës, si dhe kontekstin social-kulturor të ambientit;
- të hartojë projektin, duke konsideruar aspektet teknike të tij, përfshirë llojin e materialeve, buxhetin dhe kohën e realizimit;
- të argumentojë në mënyrë profesionale dhe bindëse zgjedhjet e projektit përpara grupeve të punës, komisioneve të vlerësimit ose klientëve, duke përdorur terminologji teknike dhe estetike;
- të përdorë mjete të ndryshme prezantimi, si prezantime fizike (modelë të thjeshtë, mostra materiali), digjitale (prezantime PowerPoint, renderime 3D) dhe multimediale (video, animacione) për të komunikuar idenë dhe konceptin në mënyrë efektive;
- të reflektojë në mënyrë kritike mbi feedback-un e marrë nga mentorët, bashkëmoshatarët dhe klientët, duke identifikuar pikat e forta dhe ato për përmirësim në koncept;
- të përmirësojë konceptin në mënyrë interaktive, duke aplikuar sugjerimet dhe duke eksperimentuar me variante të ndryshme dizajni për të arritur një zgjidhje optimale;
- të dokumentojë gjithë procesin e zhvillimit të konceptit, duke mbajtur ditar pune, përshkrime të ndryshimeve dhe justifikime për çdo fazë;

- të bashkëpunojë në mënyrë efektive me kolegët dhe profesionistët e tjerë për të përmirësuar konceptin dhe për të integruar perspektiva të ndryshme në projekt;
- të menaxhojë kohën dhe burimet gjatë procesit të zhvillimit të projektit konceptual;
- të demonstrojë kreativitet dhe inovacion në zhvillimin e zgjidhjeve që përputhen me nevojat e përdoruesit dhe kërkesat teknike, duke ruajtur një ekuilibër midis estetikës dhe funksionalitetit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 5 Nxënësi skicon projekte të dizajnit të hapësirave të brendshme.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë skica të detajuara arkitekturore dhe perspektiva me dorë, duke përdorur teknika të ndryshme vizatimi (linja, hije, ngjyrosje bazë) për të paraqitur në mënyrë ekspresive idetë e dizajnit;
- të përdorë softuerë bazë për modelim dhe vizualizim digjital të projekteve, si SketchUp, AutoCAD bazik, Revit ose software të ngjashëm, për të krijuar planimetri të sakta dhe modele 3D të ambienteve të brendshme;
- të hartojë paraqitje profesionale të projektit, duke përfshirë planimetri horizontale dhe vertikale, skica perspektivash, detaje teknike dhe renderime fillestare për të ilustruar hapësirat në mënyrë të plotë dhe të kuptueshme;
- të zhvillojë aftësi për të përdorur mjete digjitale për rregullimin e ngjyrave, teksturave dhe dritës në modelet 3D, duke përmirësuar realizmin dhe efektin vizual të projekteve;
- të integrojnë elementë grafikë në paraqitje si legjenda, shënime, dimensionime dhe simbole të standardizuara për të siguruar qartësi dhe profesionalizëm në dokumentacionin teknik;
- të demonstrojë aftësi për të përshtatur dhe paraqitur idetë në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe estetike, duke përdorur teknika vizuale që komunikojnë konceptet edhe me persona jo-specialistë;
- të hartojë portofol projektesh që përfshin skica të dorës, vizatime teknike dhe vizualizime digjitale, si dhe prezantime të strukturuar për komunikim efektiv me klientët dhe mentorët;
- të eksperimentojë me metoda të ndryshme vizatimi dhe vizualizimi për të përshtatur stilin e prezantimit me karakteristikat specifike të projektit dhe kërkesat e audiencës;
- të përdorë teknika të avancuara të perspektivës dhe proporcioneve për të siguruar që skicat dhe modelet të jenë të sakta dhe të përshtatshme për realizimin praktik;

- të përdorë edhe vizualizime të thjeshta të ndriçimit dhe materialeve, për të dhënë një ide më të plotë të ambientit të brendshëm;
- të korrigjojë dhe përmirësojë vizualizimet, bazuar në fidbek, duke përshtatur detajet teknike dhe estetike sipas kërkesave të projektit;
- të përdorë mjete dhe teknika për krijimin e prezantimeve multimediale të projekteve (p.sh., animacione të thjeshta, prezantime interaktive), për të rritur efektivitetin e komunikimit;
- të bashkëpunojë me kolegë dhe profesionistë të tjerë për të integruar vizualizimet në projektin e përgjithshëm dhe për të siguruar koherencën e konceptit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike..

RN 6 Nxënësi përzgjedhë në mënyrë funksionale dhe estetike materialet, ngjyrat dhe mobiljet.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë në mënyrë të thelluar karakteristikat teknike, funksionale dhe estetike të materialeve të ndryshme (druri, metali, xhami, tekstile, materiale sintetike etj.) për të përshtatur përdorimin e tyre në dizajnin e brendshëm;
- të vlerësojë qëndrueshmërinë, mirëmbajtjen dhe ndikimin mjedisor të materialeve për të siguruar zgjidhje që respektojnë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm;
- të përzgjedhë ngjyrat duke marrë parasysh psikologjinë e ngjyrave, harmoninë e paletës, ndikimet emocionale dhe kulturore që ato përcjellin në ambientet e ndryshme;
- të zbatojë parimet ergonomike në zgjedhjen dhe vendosjen e mobiljeve për të siguruar rehati, funksionalitet dhe qasje të lehtë në përdorim nga ana e përdoruesve;
- të hartojë kompozime të mobiljeve dhe elementëve të tjerë të brendshëm duke optimizuar rrjedhshmërinë, hapësirën dhe estetikën vizuale;
- të argumentojë zgjedhjet e materialeve, ngjyrave dhe mobiljeve nëpërmjet prezantimeve të detajuara ku evidenton avantazhet funksionale dhe estetike, si dhe kufizimet dhe sfidat e mundshme të secilës zgjidhje;
- të realizojë mostra materiale dhe kombinime ngjyrash, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., moodboards, katalogë, mostrat reale) për t'u siguruar që zgjidhjet e projektit janë të kuptueshme dhe të pranueshme për klientët dhe grupet e punës;
- të eksperimentojë me përzierjen e materialeve të ndryshme për të krijuar efekte të veçanta estetike dhe për të përmirësuar funksionalitetin e ambientit;

- të analizojë ndikimin e ndriçimit (natyral dhe artificial) në perceptimin e ngjyrave dhe materialeve në hapësirë dhe përshtat zgjedhjet për t'u optimizuar nën kushte të ndryshme drite;
- të bashkëpunojë me furnizues dhe profesionistë të tjerë për të marrë informacione të detajuara mbi karakteristikat teknike dhe çmimet e materialeve dhe mobiljeve;
- të përgatitë dokumentacion dhe prezantime profesionale që përfshijnë specifikimet teknike, mostrat dhe skemat e ngjyrave për përdorim në procesin e zbatimit të projektit;
- të përmirësojë procesin e përzgjedhjes bazuar në feedback-un e klientëve, mentorëve dhe përdoruesve të ambientit të dizajnuar;
- të zbatojë standarde dhe rregullore të sigurisë dhe higjienës në përzgjedhjen e materialeve dhe mobiljeve për të garantuar sigurinë e përdoruesve;
- të bëjë analizën e kostove dhe buxhetimit për të siguruar që zgjedhjet e dizajnit janë ekonomike dhe të realizueshme.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 7 Nxënësi realizon ndriçimin e avancuar në ambientet e brendshme.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të klasifikojë llojet kryesore të ndriçimit: natyral, artificial, i drejtpërdrejtë, i tërthortë, ambiental, funksional dhe dekorativ, duke njohur karakteristikat dhe përdorimet e secilit në dizajnin e brendshëm;
- të analizojë efektet e ndriçimit në perceptimin vizual, emocional dhe psikologjik të hapësirave të brendshme, duke marrë parasysh intensitetin, ngjyrën dhe drejtimin e dritës;
- të hartojë plane të ndriçimit që integrojnë burime të ndryshme dritash në mënyrë të ekuilibruar për të përmirësuar funksionalitetin dhe estetikën e ambienteve të ndryshme (salla pune, hapësira rezidenciale, lokale komerciale etj.);
- të përdorë teknika të avancuara si ndriçimi zonal, i fokusuar dhe i përgjithshëm për të krijuar atmosferë dhe për të nxjerrë në pah elementët kryesorë të dizajnit;
- të eksperimentojë me përdorimin e ngjyrave të ndryshme të dritës (temperaturë ngjyrash) dhe efekteve të ndriçimit (hije, reflektime, shkëlqim) për të ndryshuar perceptimin e hapësirës dhe për të theksuar elementë specifikë;
- të integrojë ndriçimin në konceptin e përgjithshëm të dizajnit, duke bashkëpunuar me elementët e tjerë vizualë dhe funksionalë për të arritur një harmoni të plotë në ambient;

- të përdorë llojet e llambave, pajisjet e ndriçimit, sistemet LED dhe teknologjitë e tjera të ndriçimit, duke vlerësuar efikasitetin energjetik dhe aspektet mjedisore;
- të hartojë modele dhe skica të sistemit të ndriçimit, duke përfshirë pozicionimin e burimeve të dritës, drejtimet, intensitetin dhe kontrollin e tyre;
- të përdorë mjete digjitale (p.sh., Dialux, Relux, AutoCAD Lighting modules) për simulimin dhe optimizimin e planeve të ndriçimit;
- të analizojë ndikimin e ndriçimit në performancën dhe mirëqenien e përdoruesve në ambiente pune dhe rezidenciale, duke marrë parasysh faktorë ergonomikë dhe psikologjikë;
- të kryejë vlerësime praktike në hapësira reale për të matur nivelin e ndriçimit dhe për të bërë rregullime të nevojshme në projekt;
- të hartojë rekomandime për mirëmbajtjen dhe përditësimin e sistemeve të ndriçimit në zbatim të projekteve të dizajnit;
- të prezantojë duke argumentuar, zgjedhjet e ndriçimit përpara klientëve ose komisioneve profesionale, duke përdorur prezantime vizuale dhe teknike;
- të reflektojë mbi përmirësimet e mundshme në dizajnin e ndriçimit bazuar në feedback dhe rezultate praktike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike..

RN 8 Nxënësi realizon projekte praktike të dizajnit të brendshëm.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë ambientin apo hapësirën për dizajnim të brendshëm;
- të analizojë me kujdes ambientin apo hapësirën për projektin praktik, duke marrë parasysh nevojat funksionale, estetike dhe kontekstuale të përdoruesit;
- të hartojë një plan pune të detajuar që përfshin hapat nga ideimi deri te realizimi përfundimtar i projektit;
- të integrojë në projekt elementët bazë dhe të avancuar të dizajnit të brendshëm, përfshirë kompozimin hapësinor, ndriçimin, materialet, ngjyrat dhe mobiljet;
- të zhvillojë moodboard-e dhe prezantime vizuale që përmbajnë konceptin dhe frymëzimet e projektit, duke përdorur mjete fizike dhe digjitale;
- të realizojë skica, planimetri, perspektiva dhe modele 3D për të vizualizuar dhe komunikuar idetë dizajnuese në mënyrë të qartë dhe profesionale;
- të përzgjedhë me kujdes materialet, ngjyrat, teksturat dhe pajisjet, duke marrë në konsideratë funksionalitetin, qëndrueshmërinë, ergonominë dhe estetikën;

- të hartojë plane të ndriçimit që përmirësojnë funksionin dhe atmosferën e ambientit, duke integruar burime të ndryshme drite dhe teknologji moderne;
- të përgatitë dokumentacion teknik dhe prezantim profesional që përfshin të gjithë komponentët e projektit, duke përdorur format standarde dhe gjuhën profesionale të dizajnit;
- të prezantojë projektin në mënyrë bindëse dhe të organizuar para një audience profesionale (kolegu, mësues, klient), duke argumentuar zgjedhjet dizajnuese dhe duke iu përgjigjur pyetjeve dhe kritikave në mënyrë konstruktive;
- të përdorë mjete multimediale (PowerPoint, video, modele 3D interaktive) për të përmirësuar prezantimin dhe për të komunikuar efektivisht idetë;
- të reflektojë në mënyrë kritike mbi procesin e punës dhe rezultatet e arritura, duke identifikuar sukseset dhe sfidat gjatë realizimit të projektit;
- të përgatitë raportin përfundimtar të projektit, që përmban përshkrimin e procesit, arsyetimin e zgjedhjeve dizajnuese, analizën e reagimeve dhe rekomandimet për përmirësime të mundshme;
- të demonstrojë aftësi menaxhimi të kohës dhe burimeve gjatë realizimit të projektit për të respektuar afatet dhe standardet e kërkuara;
- të bashkëpunojë në mënyrë efektive me kolegë dhe profesionistë të tjerë gjatë fazave të zhvillimit të projektit, duke ndarë përgjegjësi dhe duke kontribuar në mënyrë konstruktive në zgjidhjen e problemeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të zhvillohet në klasë mësimore për pjesën teorike, ndërsa për pjesën praktike duhet të zhvillohet në laborator të dedikuar projektimi ose duhet të realizohet në studio projektimi dhe dekorimi të hapësirave të brendshme.

- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe konkretizime të projektimit dhe dekorimit të avancuar të hapësirave të brendshme.
 - Nxënësit duhet të nxiten të zbatojnë sa më shumë veprimtari konkrete dhe detyra praktike për të realizuar projektimin dhe dekorimin e avancuar të hapësirave të brendshme. Ata duhet të angazhohen në bashkëbisedime profesionale në lidhje me çështjet që trajtohen në modul.
 - Mësimdhënësit duhet të përdorin sa më shumë të jetë e mundur mjetet dhe pajisjet e duhura për realizimin e projektimit dhe dekorimit të hapësirave të brendshme.
 - Mësimdhënësi mund të organizojë vizita mësimore në studio projektimi dhe dekorimi të hapësirave të brendshme.
-

	- Nxënësit inkurajohen të realizojnë projektimin dhe dekorimin e avancuar të një hapësire të caktuar, duke përdorur mjete digjitale për vizualizim dhe skicim. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të vlerësimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Ambient i pajisur me tavolina, pajisje vizatimi, kompjutera me softuerë bazë. - Mostra materiali dhe katalogë ngjyrash. - Projektor, printer për prezantime. - Mësues me përgatitje në dizajn dhe aftësi digjitale. Bordi i bardhë për skicime; - Furnizime për punime manuale (fletë, ngjyra, vizore, gërshërë, ngjitës etj.); - Galeri stilesh (foto, mostra, libra referencash); - Hapësirë për punë individuale dhe diskutime në grup. - Manuale dhe formate të dokumentacionit teknik që përdoren në sektorin e dizenjimit të ambjenteve të brendshme. - Materiale të shkruara në mbështetje të modulit.

9. Moduli “Standardet e projektimit dhe organizimi i hapësirës - 2”

Kualifikimi: Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme
Niveli: V i KSHK
Viti: II

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	STANDARDET E PROJEKTIMIT DHE ORGANIZIMI I HAPËSIRËS - 2	M-02-2343-25
Qëllimi i modulit	Ky modul ka për qëllim të pajisë nxënësit me njohuri themelore mbi standardet teknike dhe ergonomike të projektimit, rregullat funksionale të organizimit të hapësirës së brendshme, si dhe i aftëson ata të lexojnë dhe zbatojnë standardet e projektimit (si përmasa minimale, lartësi, largësi funksionale), të aplikueshme në hapësira rezidenciale dhe komerciale dhe të organizojnë në mënyrë efikase hapësira të brendshme në raport me funksionin, lëvizshmërinë, dritën natyrale dhe kërkesat e përdoruesit.	
Kohëzgjatja e modulit	140 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit kanë përfunduar modulet profesionale të vitit I të kualifikimit profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme” Niveli V i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi përgatit programin funksional të projektit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të kryejë analizën e një hapësire ekzistuese (funksion, dritë, kontekst, përdorues); – të identifikojë nevojat dhe kufizimet që lidhen me përdorimin e hapësirës; – të formulojë kërkesat funksionale dhe estetike në një përmbledhje projektimi; – të përgatisë plan fillestar ose skicë funksionale për riorganizimin e hapësirës. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Vëzhgim me listë kontrolli. – Test për aspektet teorike.
	RN 2	Nxënësi zhvillon një koncept të integruar për dizajnin e një hapësire të brendshme. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të propozojë një ide kreative në përputhje me nevojat e projektit; – të mbledhë referenca vizuale (moodboard, stil, frymëzim);

- të skicojë projektin bazuar në kontekstin konkret;
- të materializojë konceptin fillestar të ambientit të brendshëm.
- të zhvillojë përshkrimet e duhura, përshtatur me konceptin fillestar të projektit;
- të finalizojë konceptin që lidhet me funksionin dhe përjetimin estetik të hapësirës së brendshme.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 3 Nxënësi realizon dokumentacionin grafik teknik të projektit (2D dhe 3D).

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të vizatojë planimetri, pamje, prerje dhe detaje në përputhje me standardet teknike;
- të aplikojë përmasa të sakta, simbole dhe legjenda profesionale;
- të krijojë modelim 3D për paraqitjen hapësinore të projektit;
- të përdorë softuerë profesionalë (AutoCAD, SketchUp, Revit etj.) për prezantim vizual.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 4 Nxënësi përzgjedh elementet e organizimit të hapësirës për realizimin e projektit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zgjedhë materiale dhe tekstura në funksion të konceptit dhe qëndrueshmërisë;
- të përgatisë një panel materialesh me shembuj realë ose digjitalë (material board);
- të analizojë ndikimin e ngjyrës dhe ndriçimit në përjetimin e hapësirës;
- të përzgjedhë mobilje dhe pajisje të përshtatshme funksionalisht dhe estetikisht;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 5 Nxënësi finalizon dhe prezanton projektin në mënyrë profesionale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të organizojë dosjen përfundimtare të projektit (plan, renderime, përshkrim, përzgjedhje materialesh);
- të përdorë teknika të ndryshme paraqitjeje vizuale (print, ekran, katalog, 3D viewer, VR ose skenë model);
- të argumentojë projektin në prezantim përballë grupit ose simuluar për klientin;
- të reflektojë mbi punën e vet dhe sugjerime për përmirësim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 6 Nxënësi integron elementët e një koncepti të avancuar dizajni.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të vizatojë planimetri, pamje, prerje dhe detaje në përputhje me stadardet e projektimit;
- të zhvillojë një projekt që kombinon funksionin, estetikën dhe ndjesinë hapësinore;
- të analizojë ndikimin e dizajnit në përvojën e përdoruesit (ngjyra, ritmi, ndriçimi, lëvizja);
- të bëjë lidhje midis elementëve vizualë dhe reagimit emocional të përdoruesit;
- të prezantojë projektin si një zgjidhje holistike dhe jo thjesht teknike;
- të reflektojë mbi ndikimin psikologjik të zgjidhjeve të veta dizajnuese.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 7 Nxënësi vlerëson aspekte teknike, ekonomike dhe qëndrueshmërinë e projektit të zhvilluar.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përllogaritë kostot e projektit (materiale, punime, pajisje);
- të zgjedhë materiale dhe zgjidhje që përputhen me një buxhet të caktuar;
- të aplikojë parime të dizajnit të qëndrueshëm (përdorimi i materialeve ekologjike, ndriçim natyral, ripërdorim elementësh);
- të bëjë krahasim të alternativave të mundshme nga këndvështrimi ekonomik dhe mjedisor;
- të propozojë mënyra për rritjen e efikasitetit dhe uljen e ndikimit mjedisor të zbatimit të projektit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

Udhëzime për zbatimin e modulit	Ky modul duhet të trajtohet në shkollë dhe në objekte reale duke përdorur raste reale projekti të një hapësire të njohur nga nxënësi (shtëpi, dhomë, klasë, lokal etj.) për t'i dhënë kuptim konkret zbatimit të njohurive teorike. – Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet dhe argumentimet konkrete të standardeve të projektimit dhe organizimit të hapësirës së brendshme. – Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë shembuj konkret projektimi të hapësirave të ndryshme . – Mësimdhënësi duhet të përdorë simulime për praktikimin e nxënësve. – Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari dhe situata konkrete pune bazuar tek udhëzuesi i përmbushjes së aftësisë, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për aftësimin e nxënësve në zbatimin e standardeve të projektimit dhe organizimit të hapësirës së brendshme. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore dhe kabinet i kompjuterave me lidhje interneti, Klasë e pajisur me tavolina pune të përshtatshme për vizatim teknik dhe diskutim në grup; - Tabela dhe projektor për paraqitje grafike të standardeve dhe planimetrive; - Ambient laboratorik (nëse i disponueshëm) për simulime të zgjidhjeve hapësinore në shkallë të vogël. - Lapsa teknike, letra milimetrike, letër vizatimi, linjarë, trekëndësha dhe mjete për matje të saktë; - Skema model, plane teknike dhe fletë pune të strukturuar për punë individuale dhe në grup. - Softuerë për vizatim teknik dhe paraqitje (AutoCAD, SketchUp, Revit, ose programe të thjeshta 2D); - Tabela dhe projektor për shpjegim dhe analizë të rasteve konkrete; - Manuale referimi për standardet e projektimit (dimensione minimale, ergonomi, rregulla për aksesueshmëri); - Shembuj të planeve reale për analiza krahasuese dhe frymëzim.

10. Moduli “Tekstura dhe materialet ekologjike”

Kualifikimi: Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme
Niveli: V i KSHK
Viti: II

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	TEKSTURA DHE MATERIALET EKOLOGJIKE	M-02-2344-25
Qëllimi i modulit	Ky modul synon të pajisë nxënësit me njohuri dhe aftësi praktike për të përdorur tekstura dhe materiale ekologjike në funksion të dizenjimit dhe dekorimit të ambienteve të brendshme, për përzgjedhjen e materialeve të qëndrueshme për mjedisin dhe teksturat të cilat luajnë në përjetimin estetik dhe funksional të një hapësire. Moduli inkurajon përdorimin e materialeve miqësore me mjedisin si pjesë integrale e dizajnit bashkëkohor, duke lidhur krijimtarinë me përgjegjësinë ekologjike.	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të vitit I të kualifikimit profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme” Niveli V I KSHK-së.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi përshkruan teksturat dhe materialet ekologjike të përdorura në hapësira të brendshme. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të shpjegojë konceptin e teksturës në dizajnin e brendshëm; – të dallojë lloje të ndryshme teksturash (të buta, të ashpra, të natyrshme, artificiale); – të analizojë ndikimin e teksturës në ndjesinë vizuale dhe ndjesinë në prekje; – të rendisë llojet e materialeve ekologjike (drurë natyralë, tekstile organike, bambu, linoleum natyral, gurë të ricikluar etj.); – të shpjegojë përparësitë e përdorimit të materialeve ekologjike; – të krahasojë materialet tradicionale me ato ekologjike në aspektin estetik dhe funksional. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Vëzhgim me listë kontrolli. – Test për aspektet teorike.	

RN 2 Nxënësi analizon tekstura dhe materiale ekologjike në projekte praktike.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë materialet ekologjike në varësi të funksionit dhe stilit të hapësirës;
- të përdorë me saktësi materiale dhe tekstura në makete, skica apo projektin përfundimtar;
- të hartojë një projekt dizajni që përfshin minimumi tre materiale ekologjike;
- të argumentojë zgjedhjet estetike dhe funksionale;
- të përfshijë standardet e qëndrueshmërisë dhe ruajtjes së mjedisit në zgjidhjet e propozuara.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në shkollë dhe në objekte reale duke përdorur raste reale projekti të një hapësire të njohur nga nxënësi (shtëpi, dhomë, klasë, lokal etj.) për t'i dhënë kuptim konkret zbatimit të njohurive teorike.

- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të përdorimit të teksturave dhe materialeve ekologjike dhe të ilustrojë me shembuj konkret të përdorimit të tyre.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë simulime për praktikimin e nxënësve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari dhe situata konkrete pune bazuar tek udhëzuesi i përmbushjes së aftësisë, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Mësimdhënësi mund të organizojë vizita mësimore në punëtori artizanale, studio dizajni apo biznese të specializuara në mobilim dhe arredim ekologjik.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për aftësimin e nxënësve në përdorimin e teksturave dhe materialeve ekologjike në dizajn dhe dekorim të ambienteve të brendshme.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë teorike e pajisur me projektor ose ekran prezantimi.
- Ambient praktik ose laborator materialesh për analiza dhe eksperimente të thjeshta.
- Mostra reale të materialeve ndërtimore dhe dekorative: dru, gur,

tekstil, bambu, linoleum, karton, llaç, qeramikë etj..

- Mostra të materialeve ekologjike dhe të riciklueshme (fibra natyrale, plastikë të ricikluar, panele të kompozitës bio etj.).
- Panele krahasuese për tekstura të ndryshme sipas qëllimit funksional dhe estetik.
- Vegla të thjeshta për prerje, matje dhe testim të materialeve (thikë teknike, metër, peshore etj.).
- Panelet për ekspozim ose krahasim të mostrave në klasë.
- Letra teknike, lapsa, ngjyra, kolazh, ngjitës, për realizimin e moodboard-eve apo planeve prezantuese.
- Kompjuterë me programe bazë të dizajnit grafik për përgatitje skemash dhe prezantimesh;
- Broshura, katalogë të prodhuesve të materialeve ekologjike.
- Shembuj të aplikimit të materialeve në projekte reale.
- Videoteka ose galeri me ilustrime të zbatimit të materialeve në ambiente të brendshme.

11. Moduli “Realiteti virtual dhe renderimi”

Kualifikimi: Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme
Niveli: V i KSHK
Viti: II

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	REALITETI VIRTUAL DHE RENDERIMI	M-02-2345-25
Qëllimi i modulit	Ky modul ka për qëllim të pajisë nxënësit me njohuri bazë dhe aftësi praktike në krijimin e prezantimeve të avancuara vizuale për projekte të ambienteve të brendshme, përmes përdorimit të teknologjive të renderimit dhe realitetit virtual (VR), të ndërtojnë skema 3D, të aplikojnë ndriçim, tekstura dhe kamera vizuale për të paraqitur projekte sa më realiste dhe të kuptueshëm për klientët apo bashkëpunëtorët. Moduli nxit kreativitetin, të menduarit hapësinor dhe përdorimin praktik të softuerëve bashkëkohorë në funksion të dizajnit dhe komunikimit vizual.	
Kohëzgjatja e modulit	120 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të vitit I në kualifikimin profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, Niveli V I KSHK-së.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi ndërton modele të thjeshta tredimensionale për ambiente të brendshme. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përdorë një softuer modelimi 3D (p.sh. SketchUp, Blender, Twin Motion) për krijimin e objekteve dhe hapësirave të thjeshta; – të organizojë skenën me objekte, përmasa dhe pozicionim të saktë në hapësirë; – të krijojë forma të thjeshta gjeometrike tredimensionale; – të kombinojë në një strukturë të qëndrueshme vizualisht format e thjeshta gjeometrike; – të ruajë modelin në formatin përkatës; – të përgatisë skedarin për renderim për organizimin e hapësirës së brendshme. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Vëzhgim me listë kontrolli. – Test për aspektet teorike.	

RN 2 Nxënësi aplikon tekstura, materiale dhe ndriçim për krijimin e efektit realist në modele 3D.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të aplikojë tekstura dhe materiale të ndryshme sipas sipërfaqeve reale në projekt;
- të përzgjedhë burimet e ndriçimit natyral dhe artificial për të theksuar detajet e hapësirës;
- të konfigurojë pozicionimin e kamerës për këndin më efektiv të prezantimit;
- të testojë parametra të ndryshëm të dritës dhe hijes për të rritur realizmin e pamjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 3 Nxënësi realizon renderime të projektit përfundimtar për prezantim vizual profesional.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë motorë renderimi (plug-in) të integruar ose të jashtëm;
- të vendosë cilësimet për rezolucionin, përbërjen e imazhit dhe efektet vizuale;
- të eksportojë pamje statike (render) me cilësi të lartë për dokumentim ose portofol;
- të prezantojë punën përfundimtare, duke shpjeguar zgjedhjet estetike dhe teknike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 4 Nxënësi përgatit një prezantim interaktiv të projektit përmes realitetit virtual.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të konvertojë modelin përfundimtar 3D në një format të përshtatshëm për eksplorim në VR;
- të krijojë lëvizje të drejtuara në hapësirë (walkthrough) ose panorama 360°;
- të përdorë pajisje për përjetim të realitetit virtual;
- të shpjegojë mënyrën si VR ndihmon në komunikimin e idesë;
- të vlerësojë projektin nga përdoruesit finalë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në shkollë dhe në objekte reale duke përdorur raste reale projekti të një hapësire të njohur nga nxënësi (shtëpi, dhomë, klasë, lokal etj.) për t'i dhënë kuptim konkret zbatimit të njohurive teorike.

- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të përdorimit të realitetit virtual dhe renderimit dhe të ilustrojë me shembuj konkret të përdorimit të tyre.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë simulime për praktikimin e nxënësve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari dhe situata konkrete pune bazuar tek udhëzuesi i përmbushjes së aftësisë, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Mësimdhënësi mund të organizojë vizita mësimore në punëtori artizanale, studio dizajni apo biznese të specializuara në përdorimin e realitetit virtual dhe renderimit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për aftësimin e nxënësve në përdorimin e realitetit virtual dhe renderimit në dizejm dhe dekorim të ambienteve të brendshme.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Kompjuterë me performancë të lartë grafike;
- Sistemi operativ i përditësuar dhe i përshtatshëm për përdorimin e softuerëve 3D dhe VR.
- Akses në biblioteka online me materiale, objekte 3D dhe tekstura.
- Materiale ndihmëse dhe burime vizuale (Galeri me imazhe renderimi, skena VR dhe video tutoriale për secilën fazë të punës);
- Udhëzues teknikë të printuar ose digjitalë për përdorimin e softuerëve dhe eksportimin e projekteve;
- Tavolina individuale ose dyshe për punë me kompjuter;
- Kufje për punë individuale gjatë përpunimit audio/vizual.
- Softuerë të licencuar për modelim, renderim dhe VR (p.sh. SketchUp + V-Ray/Enscape, Blender, Twinmotion, Lumion);
- Pajisje shtesë për përjetim VR (opsionale): headset VR, telefon + karton VR, ose prezantim në ekran të madh;
- Galeri me referenca vizuale (projekte të renderuara, materiale dhe ndriçime reale);
- Ambient të qetë për përqendrim dhe punë kreative.

12. Moduli “Montimi dhe instalimi i strukturave në ambientet e brendshme”

Drejtimi: Ndërtim

Profili: Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme

Niveli: V i KSHK

Viti: II

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	MONTIMI DHE INSTALIMI I STRUKTURAVE NË AMBIENTET E BRENDSHME	M-02-2346-25
Qëllimi i modulit	Ky modul ka për qëllim të pajisë nxënësit me njohuri bazë dhe aftësi praktike për montimin dhe instalimin e strukturave të ndryshme ndërtimore dhe dekorative në ambientet e brendshme. Fokusi vendoset te kuptimi i proceseve teknike të montimit, përzgjedhja e duhur e materialeve dhe ndjekja e udhëzimeve teknike dhe të sigurisë gjatë realizimit të instalimeve. Nxënësit aftësohen të punojnë në mënyrë të organizuar, duke lexuar plane pune, duke përdorur manuale montimesh, si dhe duke bashkëpunuar në një mjedis praktik për përgatitjen e strukturave të brendshme funksionale dhe estetike.	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet profesionale të vitit I të kualifikimit profesional “Dizenjim dhe dekorim të ambienteve të brendshme”, Niveli V I KSHK-së.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi përgatitet për procesin e montimit sipas specifikimeve të projektit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të lexojë planin teknik dhe pozicionimin e strukturave që do të instalohen; – të përzgjedhë materialet dhe pjesët e nevojshme në përputhje me udhëzimet; – të përgatitë veglat dhe pajisjet për punë (manuale ose elektrike); – të organizojë vendin e punës sipas standardeve të higjienës dhe sigurisë; – të vlerësojë rreziqet e mundshme dhe masat parandaluese për montim të sigurt. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Vëzhgim me listë kontrolli. – Test për aspektet teorike.

RN 2 Nxënësi kryen montimin dhe instalimin e elementeve strukturore në hapësira të brendshme.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë montimin e elementeve të tilla si ndarje gipsi, mbulesa dekorative, mobilie të fiksuara apo trarë të lehtë sipas specifikimeve teknike;
- të përdorë saktë dhe në mënyrë të sigurt pajisjet dhe materialet gjatë instalimit;
- të ndjekë rendin teknik të montimit (hap pas hapi) për të siguruar qëndrueshmërinë dhe përputhshmërinë me projektin;
- të kontrollojë përputhjen e strukturës së montuar me matjet dhe pozicionet e përcaktuara;
- të aplikojë zgjidhje për gabime të vogla gjatë procesit të instalimit;
- të kryejë përfundimet estetike (rregullime, pastrim, mbulim vidash etj.).
- të bashkëpunojë me profesionalizëm, me specialistë të tjerë të fushave të prodhimit, montimit dhe instalimit të strukturave në hapësirat e brendshme.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në shkollë dhe në objekte reale duke përdorur raste reale projekti të një hapësire të njohur nga nxënësi (shtëpi, dhomë, klasë, lokal etj.) për t'i dhënë kuptim konkret zbatimit të njohurive teorike.

- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të montimit dhe instalimit të strukturave të brendshme.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë simulime për praktikimin e nxënësve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari dhe situata konkrete pune bazuar tek udhëzuesi i përmbushjes së aftësisë, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Mësimdhënësi mund të organizojë vizita mësimore në punëtori artizanale, studio dizajni apo biznese të specializuara në montimin dhe instalimin e strukturave të brendshme.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për aftësimin e nxënësve në montimin dhe instalimin e strukturave të brendshme në dizejnim dhe dekorim të ambienteve të brendshme.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për

çdo rezultat të të nxënit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Laborator praktik ose ambient pune i simuluar që lejon montimin real të strukturave në shkallë reale ose të reduktuar.
- Sipërfaqe pune të qëndrueshme për fiksime, prerje dhe testim të materialeve.
- Mjete manuale: kaçavida, çekiçë, metër, nivel, sharra dore etj..
- Pajisje elektrike bazë: vidhosës elektrik, sharrë elektrike portative, pistoletë silikonit etj..
- Pajisje matëse dhe kontrolli nivelë uji, metër lazer, kuadrantë.
- Profile metalike dhe druri për skelet struktural;
- Panele të gipsit, druri, OSB, MDF ose materiale të tjera të lehta për ndarje apo panele dekorative;
- Elementë bashkues: vidha, vida, gozhdë, fisha, shirita ngjitës etj.
- Skema dhe plane teknike për strukturat që do të instalohen;
- Udhëzime me hapa për montimin dhe materialet përkatëse;
- Broshura ose manuale teknike të produkteve që përdoren;
- Pajisje individuale mbrojtëse për nxënësit: doreza pune, syze mbrojtëse, maska pluhuri, veshje pune;
- Tavolina ose raftet për ruajtjen e sigurt të veglave dhe materialeve;
- Sinjalistikë për sigurinë dhe manual i procedurave të punës;
- Postera informuese dhe ilustrime me fazat e montimit.
- Mostra materiale për instalim: profile metalike, panele gipsi, vidha, mbështetëse druri, etj.;
- Masa sigurie dhe veshje mbrojtëse për nxënësit (doreza, syze, maskë pluhuri);
- Plane teknike të thjeshta dhe udhëzime për ndërtimin ose montimin e strukturave.

13. Moduli “Komunikimi profesional dhe menaxhimi i klientit”

Drejtimi: Ndërtim

Profili: Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme

Niveli: V i KSHK

Viti: II

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	KOMUNIKIMI PROFESIONAL DHE MENAXHIMI I KLIENTIT	M-38-2347-25
Qëllimi i modulit	Ky modul i njeh dhe i aftëson nxënësit me parimet bazë të komunikimit profesional në mjedisin e punës. Moduli i aftëson nxënësit të përdorin teknika të komunikimit verbal dhe joverbal, të zhvillojnë aftësi prezantuese dhe dëgjimi aktiv, si dhe të menaxhojnë situata të ndryshme ndërveprimi me klientët në procesin e dizajnit dhe arredimit të brendshëm.	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit kanë përfunduar modulet profesionale të vitit të I të kualifikimit profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, Niveli V i KSHK-së.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi komunikon profesionalisht në ambientin e punës. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të zbatojë parimet e etikës profesionale në të gjitha situatat e punës, duke përfshirë respektimin e pronës intelektuale dhe të drejtave të klientëve; – Të zbatojë rregullat e mirësjelljes në komunikimin verbal dhe jo verbal gjatë takimeve me klientët, bashkëpunëtorët dhe furnizuesit; – Të dëgjojë në mënyrë aktive duke respektuar kërkesat dhe preferencat e klientëve për të krijuar zgjidhje të personalizuar; – Të përdorë në mënyrë korrekte terminologjinë profesionale dhe të komunikimit, në ambientin e punës dhe në prezantimet e projekteve; – Të mbrojë të dhënat dhe informacionet konfidenciale të klientëve dhe projekteve, sipas standardeve të privatësisë; Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Vëzhgim me listë kontrolli. – Test për aspektet teorike. RN 2 Nxënësi menaxhon marrëdhëniet me klientin. Kriteret e vlerësimit:	

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përditësojë vazhdimisht informacionet për përmbushjen e detyrave të ditës;
- Të zbatojë parimet e punës në grup në mënyrë të frytshme dhe korrekte;
- Të bashkëpunojë rregullisht dhe efektivisht me eprorët dhe kolegët;
- Të marrë pjesë në veprimtari profesionale në bashkëpunim me të tjerët, duke respektuar parimet e punës në ekip;
- Të trajtojë ankesat dhe mosmarrëveshjet me klientët, në mënyrë profesionale;
- Të përdorë teknologjitë bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit në mënyrë efikase në menaxhimin e marrëdhënieve me klientin;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike..

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul realizohet në shkollë ose në mjedis real pune për dizenjim dhe dekorim të ambienteve të brendshme.

- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë ilustrime konkrete, shembuj nga praktika profesionale dhe simulime të situatave të komunikimit real me klientin.
- Nxënësit duhet të përfshihen në role aktive përmes lojërave me role, prezantimeve, diskutimeve në grup dhe zgjidhjes së situatave konfliktuale apo të zakonshme në marrëdhëniet me klientin.
- Duhet të nxitet përdorimi i mjeteve dhe platformave të komunikimit profesional (si e-mail, formularë kontakti, platforma digjitale të shërbimeve) për të përforcuar aftësitë praktike.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te demonstrimi praktik i aftësive komunikuese, etikës profesionale dhe menaxhimit të situatave reale në marrëdhëniet ndërpersonale dhe me klientët.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të vlerësimit të specifikuar për çdo rezultat të nxënësve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore dhe ambiente për zhvillimin e simulimeve dhe punës në grup, të pajisura me teknologji audio-vizuale (projektor, ekran) për prezantime;
- Kompjuterë ose laptopë me lidhje interneti dhe akses në platforma komunikimi profesional (e-mail, programe për menaxhimin e marrëdhënieve me klientin, etj.);
- Materiale didaktike që përfshijnë skenarë komunikimi, raste studimore dhe fletë punimi për zhvillimin e situatave

-
- praktike të komunikimit me klientët;
- Udhëzues mbi etikën profesionale dhe standardet e komunikimit në fushën e dizajnit dhe arredimit të brendshëm;
 - Mjete për lojë me role dhe simulime të situatave të shërbimit ndaj klientit;
 - Materiale për punë në grup dhe prezantime, si dhe mjete kancelarie;
 - Mbështetje nga profesionistë të fushës për ligjërata ose konsultime praktike, kur është e mundur;
 - Burime online dhe materiale multimediale për vetë-mësim dhe zhvillim të mëtejshëm.

14. Moduli “Etika, komunikimi dhe sipërmarrja profesionale

Kualifikimi: Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme
Niveli: V i KSHK
Viti: II

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	ETIKA, KOMUNIKIMI DHE SIPËRMARRJA PROFESIONALE	M-38-2348-25
Qëllimi i modulit	Qëllimi i këtij moduli është të zhvillojë te nxënësit njohuritë dhe aftësitë bazë për të praktikuar etikën profesionale, komunikimin efektiv dhe sipërmarrjen në mjedisin e punës. Moduli synon të pajisë nxënësit me parimet e sjelljes etike, teknikat e komunikimit ndërpersonal dhe profesional, si dhe konceptet themelore të sipërmarrjes, për të ndihmuar në ndërtimin e një qëndrimi përgjegjës dhe iniciativë në karrierën e tyre profesionale.	
Kohëzgjatja e modulit	70 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit kanë përfunduar modulet profesionale të vitit të I të kualifikimit profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, Niveli V i KSHK-së.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi zhvillon aftësitë sipërmarrëse. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përshkruajë hapat e krijimit të një sipërmarrjeje; – të kryejë një studim tregu për të zhvilluar idenë sipërmarrëse; – të demonstrojë aftësi për të zhvilluar dhe menaxhuar një projekt/ide sipërmarrëse, duke planifikuar dhe zbatuar një buxhet të caktuar; – të përshkruajë rëndësinë e mendimit kritik dhe krijues ndaj zgjedhjeve të bëra; – të zbatojë teknikat e marketingut për promovimin e shërbimeve dhe produkteve në mënyrë efektive. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Vëzhgim me listë kontrolli. – Test për aspektet teorike.
	RN 2	Nxënësi kryen veprimtari për zhvillimin e vazhduar profesional. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të kryejë vetvlerësimin për identifikimin e nevojave për zhvillim të vazhduar profesional, sipas teknikave të përcaktuara;

- të përdorë literaturën bashkëkohore për zhvillim profesional dhe përmirësim të praktikave të punës;
- të marrë pjesë aktivisht në panairë, ekspozita, trajnime dhe kurse teknike për avancim profesional;
- të transmetojë në kohë njohuritë dhe aplikimin e teknikave të reja të bashkëpunëtorët;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

RN 3 Nxënësi zbaton kuadrin ligjor dhe rregullat e menaxhimit financiar në aktivitetet profesionale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zbatojë legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe ligjet në fushën e aktivitetit të tij profesional;
- të regjistrojë saktë të dhënat e faturave, sipas formatit të kërkuar;
- të përgatisë oferta për klientët, sipas kërkesave të tyre;
- të krahasojë çmimet e tregut të materialeve bazuar në standardet e ndërtimit;
- të llogarisë me saktësi koston e materialeve dhe çmimin e shërbimeve të ofruara;
- të kryejë blerjet e materialeve, mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme në mënyrë efektive dhe me përgjegjësi;
- të llogarisë çmimin përfundimtar të punimeve dhe shërbimeve duke marrë parasysh të gjitha kostot;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të zhvillohet në klasë dhe në mjedise praktike ku nxënësit mund të simulojnë situata reale profesionale, si prezantime, diskutime dhe bashkëpunim në grupe;
- Mësuesi duhet të përdorë metoda aktive mësimore, përfshirë raste studimore, lojën me role dhe ushtrime praktike që nxisin komunikimin efektiv dhe zbatimin e etikës profesionale;
 - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari që forcojnë aftësitë e komunikimit verbal dhe joverbal, si dhe të praktikojnë sjelljet etike në marrëdhëniet me kolegët, klientët dhe partnerët;
 - Nxënësit duhet të zhvillojnë mini-projekte sipërmarrëse, duke zbatuar njohuritë mbi etikën, komunikimin dhe menaxhimin e burimeve në mënyrë të përgjegjshme;
 - Gjatë mësimit duhet të inkurajohet përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit për realizimin e prezantimeve, kërkimeve dhe bashkëpunimit online;
 - Vlerësimi i nxënësve duhet të fokusohet në demonstrimin praktik të njohurive dhe aftësive të fituara, duke përfshirë

	mënyrën e komunikimit, zbatimin e parimeve etike dhe aftësinë për të planifikuar aktivitete sipërmarrëse; - Arritja e pranueshme e modulit vlerësohet me përmbushjen e kriterëve të përcaktuara për secilin rezultat të të nxënit dhe angazhimin në veprimtaritë praktike të modulit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Mjedis mësimor i përshtatshëm, si klasë dhe kabinet për aktivitetet grupore dhe diskutimet; - Pajisje teknologjike, si kompjutera me lidhje interneti, projektor dhe pajisje për prezantime multimediale; - Materiale didaktike dhe leksione të përgatitura që përmbajnë raste studimore, skenarë komunikimi dhe shembuj sipërmarrës; - Librari dhe burime elektronike për mbështetje të njohurive mbi etikën, komunikimin dhe sipërmarrjen; - Mjetet për zhvillimin e aktiviteteve praktike, si fletë pune, materiale për role-play dhe ushtrime simuluese; - Disponueshmëria e mësuesve me njohuri të thella mbi fushën e etikës profesionale, komunikimit dhe sipërmarrjes; - Mundësi për pjesëmarrje në aktivitete jashtë shkollore, si punëtori, seminare, panairë dhe ekspozita;

15. Moduli “Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit”

Kualifikimi: Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme
Niveli: V i KSHK
Viti: II

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	ZBATIMI I RREGULLAVE TË SIGURIMIT TEKNIK DHE TË RUAJTJES SË MJEDISIT	M-05-2349-25
Qëllimi i modulit	Ky modul ka për qëllim që të njohë nxënësit me standardet dhe legjislacionin shqiptar për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e mjedisit në vendin e punës, si dhe i aftëson ata të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik në mënyrë të sigurtë gjatë punimeve në lartësi, në ambiente elektrike dhe në përdorimin e pajisjeve mbrojtëse dhe rregullat për ruajtjen e mjedisit duke menaxhuar si duhet mbetjet, duke përdorur rregulloret përkatëse dhe duke ndjekur protokollet për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që mund të dëmtojnë mjedisin.	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit kanë përfunduar modulet profesionale të vitit të I të kualifikimit profesional “Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, Niveli V i KSHK-së.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi zbaton rregullat e sigurimit teknik. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të zbatojë standardet dhe legjislacionin shqiptar për sigurimin teknik në punë; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik për veten dhe ekipin gjatë punimeve në lartësi; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës në ambiente elektrike me tension dhe rrezik zjarri; – të përdorë pajisje mbrojtëse individuale dhe kolektive sipas rregullave dhe procedurave të punës; – të përdorë mjetet dhe pajisjet e punës sipas manualeve përkatëse; – të përdorë pajisjet e mbrojtjes nga zjarri, kontaktit me energjinë elektrike dhe shpëtimit sipas rregullores; – të japë ndihmën e parë në rast aksidenti ose goditje nga rryma elektrike, sipas udhëzimeve përkatëse; – të zbatojë procedurat e evakuimit për raste emergjence sipas protokolleve. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Vëzhgim me listë kontrolli. – Test për aspektet teorike..	

RN 2 Nxënësi zbaton rregullat e ruajtjes së mjedisit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
- të zbatojë rregulloret për depozitimin e mbetjeve në përputhje me ligjet dhe rregulloret mjedisore;
- të zbatojë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
- të zbatojë protokollet e duhura në raste të gjendjeve të jashtëzakonshme që prekin mjedisin dhe sigurinë;
- të demonstrojë përgjegjësi për ruajtjen e mjedisit gjatë të gjithë procesit të punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike..

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Moduli duhet të realizohet në kushte praktike, në laboratorë ose vende pune që pasqyrojnë ambientet reale të punës, për të mundësuar simulimin e situatave të ndryshme të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
- Nxënësit duhet të praktikojnë përdorimin e pajisjeve mbrojtëse, procedurat e dhënies së ndihmës së parë dhe evakuimit në raste emergjence;
- Duhet të organizohen vizita ose bashkëpunime me institucione ose kompani që veprojnë në fushën e sigurimit teknik dhe mjedisit, për të njohur praktikat reale;
- Gjatë vlerësimit duhet të vihet theksi në demonstrimin praktik të njohurive dhe zbatimin korrekt të rregullave të sigurimit dhe mjedisit;
- Arritja e pranueshme e modulit vlerësohet me përmbushjen e të gjitha kriterëve të vlerësimit dhe angazhimin në aktivitetet praktike.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Ambient mësimor i pajisur me laboratorë praktikë ose hapësira të sigurta për zhvillimin e ushtrimeve të sigurimit teknik;
 - Pajisje mbrojtëse individuale dhe kolektive për nxënësit, si helmet, doreza, veshje mbrojtëse, syze, maska, etj.;
 - Mjete dhe pajisje për dhënien e ndihmës së parë dhe për evakuim në raste emergjence;
 - Materiale didaktike për sigurimin teknik dhe ruajtjen e mjedisit, përfshirë manuale, rregullore, udhëzime dhe raste studimore;
 - Pajisje multimediale për prezantime dhe demonstrime;
 - Disponueshmëria e mësuesve me njohuri të specializuara në fushën e sigurimit teknik dhe mjedisit;

-
- Mundësi për organizimin e vizitave studimore ose bashkëpunimeve me institucione profesionale;
 - Materiale për praktikë të ndarjes së mbetjeve dhe magazinimit të sigurtë të materialeve.

16. Moduli “Zhvillimi i portofolit profesional”

Kualifikimi: Dizënjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme
Niveli: V i KSHK
Viti: II

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	ZHVILLIMI I PORTOFOLIT PROFESIONAL	M-39-2350-25
Qëllimi i modulit	Ky modul synon të aftësojë nxënësit për krijimin dhe organizimin e portofolit të tyre profesional, duke përfshirë dokumentacionin, projektet dhe dëshmitë e aftësive të fituara gjatë arsimit dhe praktikës, si dhe për prezantimin në mënyrë efektive të punës dhe kompetencave të tyre për tregun e punës ose për vazhdimin e studimeve, duke përfshirë përdorimin e mjeteve digjitale për krijimin dhe mirëmbajtjen e portofolit.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit kanë përfunduar modulet profesionale të vitit të I të kualifikimit profesional “Dizënjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme”, Niveli V i KSHK-së.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi krijon portofolin profesional. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përzgjedhë materialet dhe dokumentet që do të përfshihen në portofol; – të hartojë CV-në/jetëshkrimin; – të përgatitë dëshmitë e aftësive dhe certifikatave; – të përzgjedhë dhe organizojë skicat dhe vizatimet teknike të projekteve të dizajnit të brendshëm; – të përdorë modele 3D dhe renderime për të ilustruar konceptet e dizajnit; – të krijojë moodboard-e dhe paleta të ngjyrave për të paraqitur idetë kreative; – të dokumentojë fazat e realizimit të projekteve, duke përfshirë foto dhe përshkrime; – të integrojë kërkesat e klientit dhe zbatimin e standardeve profesionale në çdo projekt; – të përdorë softuerë të specializuar për dizajnin e brendshëm në krijimin e portofolit; – të përgatitë prezantime të qarta dhe bindëse për t'i paraqitur klientëve ose punëdhënësve. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Vëzhgim me listë kontrolli. – Test për aspektet teorike.	

RN 2 Nxënësi prezanton portofolin profesional.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë teknikat e prezantimit verbal dhe jo verbal të portofolit;
- të përdorë mjetet digjitale gjatë prezantimit;
- të zhvillojë aftësitë për komunikim efektiv me punëdhënësit dhe kolegët;
- të prezantojë portofolin në tregun e punës dhe panaireset përkatëse;
- të prezantojë portofolin për kualifikime të mëtejshme.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Test për aspektet teorike..

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Moduli duhet të zhvillohet në mjedise ku nxënësit kanë mundësi të përdorin pajisje dhe softuerë të specializuar për dizajnin e brendshëm (p.sh. CAD, SketchUp, Revit);
- Mësimdhënësi duhet të sigurojë demonstrime praktike të përdorimit të mjeteve dhe teknikave të ndryshme për krijimin e projekteve dhe portofolit;
- Nxënësit duhet të angazhohen në ushtrime praktike që përfshijnë hartimin, skicimin dhe modelimin 3D të projekteve të dizajnit;
- Duhet të inkurajohet puna në grup dhe bashkëpunimi për të shkëmbyer ide dhe për të përmirësuar aftësitë komunikuese dhe prezantuese;
- Nxënësit duhet të praktikojnë përgatitjen dhe organizimin e portofolit duke përfshirë dokumente, skica dhe prezantime multimediale;
- Vlerësimi duhet të fokusohet në demonstrimin praktik të aftësive, kreativitetit dhe përdorimit efektiv të teknologjisë;
- Mësuesi duhet të monitorojë vazhdimisht progresin e nxënësve dhe të ofrojë feedback konstruktiv gjatë gjithë realizimit të modulit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë ose laborator i pajisur me kompjutera modernë dhe lidhje interneti me shpejtësi të qëndrueshme;
 - Softuerë të specializuar për dizajnin e brendshëm si CAD, SketchUp, Revit, ose programe të ngjashme për modelim 3D dhe vizatim teknik;
 - Pajisje multimediale për prezantime dhe demonstrime, si projektorë dhe ekrane;
 - Materiale didaktike që përfshijnë manuale, udhëzues dhe shembuj të portofolit profesional;
 - Hapësira për ushtrime praktike ku nxënësit mund të punojnë

individualisht ose në grupe;

- Akses në burime online dhe literatura bashkëkohore për dizajnin e brendshëm dhe krijimin e portofolit;
- Mësues me njohuri të thella në fushën e dizajnit të brendshëm dhe teknologjive digjitale;
- Mundësi për vizita studimore në studio dizajni ose ekspozita profesionale për të njohur praktikat reale.

IX. Programi i përgjithshëm i praktikës profesionale të grupuar, në biznes.

1. Programi i përgjithshëm i praktikës profesionale në biznes për vitin I

Kohëzgjatja: 15 ditë praktikë x 10 orë mësimore/ditë = 150 orë mësimore

Nr	Vendi i praktikës	Veprimtgaritë	Veprimtaritë praktike	Koha (ditë/orë mësimore)
1	Në studio projektimi dhe dekorimi të ambienteve të brendshme	Stilet në dizënjim dhe dekorim	- Përdorimi i dokumentacionit përkatës për dizënjim dhe dekorim të ambienteve të brendshme. - Zhvillimi i një koncepti të thjeshtë dizajni për një hapësirë të caktuar. - Ndërtimi i vizatimeve në projeksione ortogonale - Zbatimi i rregullave të vizatimit teknik. - Realizimi i figurave gjeometrike në hapësirë. - Zbatimi i rregullave të sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit. - Komunikimi me etikë dhe profesionalizëm.	4 ditë / 40 orë mësimore
2	Në studio projektimi dhe dekorimi të ambienteve të brendshme	Vizatimi teknik e digjital dhe ngjyrat dhe ndriçimi në hapësirë	- Përdorimi i mjeteve dhe teknikave të vizatimit teknik. - Realizimi i vizatimeve teknike me softuere të specializuar. - Realizimi i paraqitjeve vizuale për ndërtimin e skemave ose planeve funksionale. - Zbatimi i teknikave të ndriçimit në dizajnin e brendshëm. - Zbatimi i rregullave të sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit. - Komunikimi me etikë dhe profesionalizëm.	4 ditë / 40 orë mësimore
3	Në studio projektimi dhe dekorimi të ambienteve të brendshme	Projektimi e dekorimi i hapësirave të brendshme dhe standardet e	- Përdorimi i dokumentacionit teknik për projektim dhe dekorim të hapësirave të brendshme.	7 ditë / 70 orë mësimore

		projektimit dhe organizimit të hapësirës	- Analiza e elementëve vizualë dhe të hapësirës në dizajn. - Zhvillimi i konceptit të dizajnit të brendshëm. - Organizimi funksional i një hapësirë të brendshme. - Përshtatja e standardeve të projektimit dhe organizimit të hapësirave të brendshme për kategori të ndryshme përdoruesish. - Zbatimi i rregullave të sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit. - Komunikimi me etikë dhe profesionalizëm.	
			Totali	15 ditë /150 orë mësimore

2. Programi i përgjithshëm i praktikës profesionale në biznes për vitin II

Kohëzgjatja: 15 ditë praktikë x 10 orë mësimore/ditë = 150 orë mësimore

Nr	Vendi i praktikës	Veprimtaritë	Kompetencat profesionale	Koha (ditë/orë mësimore)
1	Në studio projektimi dhe dekorimi të ambienteve të brendshme	Projektimi dhe dekorimi i hapësirave të brendshme	- Të identifikojë konceptin e avancuar dhe funksionin e dizajnit të brendshëm. - Të aplikojë elementët e avancuar vizualë dhe të hapësirës. - Të zbatojë parimet e avancuara të kompozimit dhe organizimit të hapësirës. - Të hartojë projektin konceptual të dizajnit të brendshëm. - Të dokumentojë procesin e zhvillimit të konceptit. - Të skicojë projektin e dizajnit të brendshëm. - Të bëjë përzgjedhjen funksionale dhe estetike të materialeve, ngjyrave dhe mobiljeve. - Të realizojë ndriçimin e avancuar në ambientet e brendshme. - Të realizojë projektet praktike të dizajnit të brendshëm.	5 ditë / 50 orë mësimore

			- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit. - Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.	
2	Në studio projektimi dhe dekorimi të ambienteve të brendshme	Zbatimi i standardeve të projektimit dhe organizimi i hapësirës.	- Të përgatitë programin funksional të projektit. - Të zhvillojë një koncept të integruar për dizajnin e një hapësire të brendshme. - Të realizojë dokumentacionin grafik teknik të projektit (2D dhe 3D). - Të përzgjedhë elementet e organizimit të hapësirës për realizimin e projektit. - Të finalizojë dhe prezantojë projektin në mënyrë profesionale. - Të integrojë elementët e një koncepti të avancuar dizajni. - Të vlerësojë aspektet teknike, ekonomike dhe qëndrueshmërinë e projektit të zhvilluar. - Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit. - Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.	3 ditë / 30 orë mësimore
3	Në studio projektimi dhe dekorimi të ambienteve të brendshme	Përdorimi i realitetit virtual dhe renderimi	- Të ndërtojë modele të thjeshta tredimensionale për ambiente të brendshme. - Të aplikojë tekstura, materiale dhe ndriçim për krijimin e efektit realist në modele 3D. - Të realizojë renderime të projektit përfundimtar për prezantim vizual profesional. - Të përgatitë një prezantim interaktiv të projektit përmes realitetit virtual - Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit. - Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.	3 ditë / 30 orë mësimore
4	Në objekte reale të një hapësire të njohur nga nxënësi (shtëpi, dhomë, klasë, lokal etj.)	Montimi dhe instalimi i strukturave në ambientet e brendshme	- Të përgatitet për procesin e montimit sipas specifikimeve të projektit. - Të kryejë montimin dhe instalimin e elementeve strukturore në hapësira të brendshme. - Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.	4 ditë / 40 orë mësimore

			- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm	
			Totali	15 ditë /150 orë mësimore

X. Programi orientues i provimeve përfundimtare të nivelit V të KSHK-së.

Programi orientues për provimet përfundimtare të nivelit për kualifikimin profesional "Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme", Niveli V i KSHK-së përmban njohuritë profesionale dhe kompetencat profesionale më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim profesional, për të cilat nxënësi duhet të vlerësohet në provimet përfundimtare.

Ky program i ndihmon nxënësit të përqendrohen në ato njohuri (koncepte, parime, ligjësi, procedura etj.) dhe kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësimdhënësit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të nxënësit.

Për drejtuesit e shkollave, këto programe krijojnë mundësinë e verifikimit paraprak të shkallës së përgatitjes përfundimtare të nxënësve, i cili mund të realizohet duke zhvilluar testime përmbledhëse.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t'i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e nxënësit në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit dhe kualifikimit të mëtejshëm.

Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimet përfundimtare, është e rëndësishme që herë pas here mësimdhënësit të zhvillojnë testime, me teste teorike dhe praktike, që mund t'i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh njohuritë dhe kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin. Programi orientues përbëhet nga dy pjesë:

- programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar;
- programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar.

A. Programi orientues i Provimit të Teorisë Profesionale të Integruar

Programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar, në kualifikimin profesional "Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme", Niveli V në KSHK është hartuar duke u mbështetur në modulet/rezultatet e të nxënit, të cilat mbulojnë çështje teorike profesionale.

Njohuritë profesionale të përfshira në programin orientues dhe peshat e tyre përkatëse janë:

Tabela 1: Modulet/njohuritë profesionale dhe peshat përkatëse në programin orientues.

Nr.	Modulet mësimore/Njohuritë profesionale	Peshat në %
1	Bazat e dizenjimit të brendshëm - Koncepti dhe objektivat kryesorë të dizajnit të brendshëm. - Llojet e ndryshme të hapësirave. - Profesione të lidhura me dizajnim të brendshëm. - Roli i dizajnit në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe përdorshmërisë së hapësirave.	5 %

	- Elementët përbërës (linja, forma, ngjyra, drita, tekstura, përmasa, hapësira) dhe funksionet e tyre. - Dallimi i elementeve vizualë nga ato funksional.	
2	Stilet në dizajnim dhe dekorim - Periudhat kryesore të historisë së dizajnit të brendshëm (klasik, barok, modern, post-modern etj.). - Identifikimi i karakteristikave kryesore të secilit stil (format, ngjyrat, materialet, motivet dekorative, ndriçimi, përdorimi i hapësirës). - Ndikimi i kontekstit social dhe kulturor në zhvillimin e stileve të ndryshme. - Tiparet dalluese të stileve nëpërmjet analizës së imazheve dhe hapësirave ekzistuese. - Analiza e përdorimit të ngjyrave, formave, ndriçimit dhe teksturave në çdo stil. - Marrëdhënia midis funksionalitetit dhe estetikës në hapësirat e stilizuara dhe dallimet e tyre.	5 %
3	Gjeometri deskriptive - Kuptimi i gjeometrisë deskriptive, qëllimi dhe aplikimet e saj në fushat teknike dhe të dizajnit. - Llojet e projeksioneve dhe përdorimi i tyre. - Dallimi ndërmjet vizatimit artistik dhe atij teknik në funksionin e tyre. - Terminologjinë teknike të përdorur në përshkrimin e formave dhe pozicioneve në hapësirë.	5 %
4	Vizatimi teknik dhe digjital - Identifikimi dhe përdorimi i instrumenteve tradicionale të vizatimit teknik (vizore, trekëndësja, kompasa etj.). - Teknikat e vijëzimit sipas standardeve teknike. - Teknikat e hijëzimit sipas standardeve teknike. - Teknikat e përmasimit sipas standardeve teknike. - Vizatimi i figurave gjeometrike për përfaqësimin e formave, objekteve dhe hapësirave. - Pastërtia dhe organizimi në paraqitjen grafike.	10 %
5	Ngjyrat dhe ndriçimi në natyrë - Kuptimi i teorisë së ngjyrave. - Marrëdhëniet midis ngjyrave (kontrasti, harmonia, temperatura e ngjyrës). - Spektri i ngjyrave (tonaliteti, saturation, drita). - Psikologjia e ngjyrës dhe ndikimi në perceptimin e hapësirës; - Përdorimi i ngjyrave për të theksuar, korrigjuar ose organizuar vizualisht hapësirën. - Llojet e ndriçimit (natyral, artificial, i drejtpërdrejtë, i tërthortë). - Ndikimi i ndriçimit në perceptimin e ngjyrës dhe forms. - Ndriçimi funksional dhe ai dekorativ. - Pajisjet ndriçuese dhe pozicionimi i tyre në hapësirë; - Koncepti i temperaturës së dritës (Kelvin) dhe rendimenti i ngjyrave (CRI).	10 %
6	Projektimi dhe dekorimi i hapësirave të brendshme (1 dhe 2) - Koncepti i dizajnit të brendshëm dhe funksionet kryesore të tij.	15 %

	- Roli i dizajnit të brendshëm në formësimin e përvojës së përditshme të individit në ambiente të ndryshme. - tipologjitë kryesore të hapësirave të brendshme. - Roli i profesionistëve të ndryshëm në procesin e dizajnit të brendshëm. - Roli i teksturës në pasurimin vizual dhe taktil të sipërfaqeve të brendshme. - Rëndësia e dritës në funksionalitetin dhe estetikën e hapësirës. - Ndikimi psikologjik i elementëve vizualë te përdoruesi. - Balanca dhe harmonia ndërmjet elementëve vizualë në krijimin e një ambienti funksional dhe estetik. - Përzgjedhja e materialeve dhe ngjyrave në raport me përdoruesin dhe funksionin e hapësirës. - Ndikimi kulturor dhe social të elementëve vizualë në dizajn. - Koncepti i ritmit në dizajn. - Uniteti, koherenca dhe lidhja midis të gjitha pjesëve të një dizajni. - Kontrasti si element i kundërt për të krijuar interes vizual dhe theksim. - Parimi i proporcionit dhe shkallës për të krijuar marrëdhënie të përshtatshme midis elementëve dhe përdoruesit. - Harmonia si kombinim i suksesshëm i elementëve që përputhen natyrshëm. - Parimet e projektimit dhe dekorimit të hapësirave ekzistuese. - Procesi i zhvillimit të një koncepti si bazë krijuese për projektin e dizajnit të brendshëm. - Krijimi i moodboard-vee për të shprehur vizualisht atmosferën, stilin, ngjyrat dhe materialet e përzgjedhura për projektin. - Forma të ndryshme prezantimi për të komunikuar idetë: skica të dorës, kolazh, përshkrime tekstuale, digjitale apo fizike. - Konceptet fillestare të dizajnit duke integruar reflektime mbi qasjet funksionale dhe estetike. - Përgatitja e prezantimeve profesionale me mjete të avancuara vizuale dhe digjitale; - Teknologjia digjitale (softuerë për modelim 3D, vizualizime, prezantime multimediale) për të zhvilluar dhe paraqitur elementët vizualë dhe të hapësirës në projektet e dizajnit të brendshëm; - Roli i dritës artificiale dhe natyrore në hapësira të ndryshme. - Krijimi i ambienteve të balancuara, funksionale dhe me estetikë të lartë. - Përzgjedhjet estetike dhe funksionale në projektimin dhe dekorimin e hapësirave të brendshme. - Materiale të ndryshme dhe kombinimi i tyre me ngjyra, tekstura dhe drita, për të krijuar eksperiencë multisensoriale në ambientet e brendshme. - Parimet kryesore të kompozimit.	
7	Standardet e projektimit dhe organizimi i hapësirës (1 dhe 2) - Përmasat standarde për elementët bazë të ambienteve (dyshe, tavane, dritare, dyer, korridore, mobilie). - Distancat funksionale midis objekteve dhe zonave të përdorimit. - Shenjat konvencionale të instalimeve (elektrike, furnizime uji,	10 %

	kanalizim, ngrohje-ftoje-ventilim, gaz etj.). - Leximi i skemave teknike dhe interpretimi i të dhënave standarde nga manuale profesionale. - Standardet ergonomike në ambiente të ndryshme (banim, punë, shërbim);. - Rëndësia e respektimit të standardeve për funksionalitetin dhe komoditetin. - Rregullat e aksesueshmërisë (akses me karrocë, nivele, dritare të ulëta, doreza etj.). - Analiza e një hapësire ekzistuese, nevojave të dhe kufizimeve që lidhen me përdorimin e hapësirës. - Kërkesat funksionale dhe estetike në një përmbledhje projektimi. - Përgatitja e planit fillestar ose skicës funksionale për riorganizimin e hapësirës. - Përmasat, simbolet dhe legjenda profesionale. - Modelimi 3D për paraqitjen hapësinore të projektit. - Softuerët profesionalë (AutoCAD, SketchUp, Revit, etj.) për prezantim vizual. - Përlllogaritja e kostove të projektit (materiale, punime, pajisje etj.). - Parimet e dizajnit të qëndrueshëm (përdorimi i materialeve ekologjike, ndriçim natyral, ripërdorim elementësh). - Krahësimi i të mundshme nga këndvështrimi ekonomik dhe mjedisor. - Mënyrat për rritjen e efikasitetit dhe uljen e ndikimit mjedisor të zbatimit të projektit.	
8	Tekstura dhe materialet ekologjike - Koncepti i teksturës në dizajnin e brendshëm dhe llojet e ndryshme të tyre (të buta, të ashpra, të natyrshme, artificiale). - Ndikimi i teksturës në ndjesinë vizuale dhe ndjesinë në prekje dhe llojet e materialeve ekologjike. - Përparësitë e përdorimit të materialeve ekologjike dhe dallimi i materialeve tradicionale me ato ekologjike në aspektin estetik dhe funksional.	5 %
9	Realiteti virtual dhe renderimi - Konvertimi i modelit përfundimtar 3D në një format të përshtatshëm për eksplorim në VR. - Krijimi i lëvizjeve të drejtuara në hapësirë (walkthrough) ose panorama 360°. - Përdorimi i pajisjeve për përjetim të realitetit virtual. - Mënyra se si VR ndihmon në komunikimin e idesë.	5 %
10	Montimi dhe instalimi i strukturave në ambientet e brendshme - Leximi i planit teknik dhe pozicionimi i strukturave që do të instalohen. - Materialet dhe pjesët e nevojshme sipas udhëzimeve. - Veglat dhe pajisjet për punë (manuale ose elektrike). - Organizimi i vendit të punës. - Rreziqet e mundshme dhe masat parandaluese për montim të sigurt.	10%
11	Komunikimi profesional dhe menaxhimi i klientit	5 %

	- Parimet e etikës profesionale në të gjitha situatat e punës dhe respektimi i pronës intelektuale dhe të drejtat e klientëve. - Rregulla e mirësjelljes në komunikimin verbal dhe joverbal gjatë takimeve me klientët, bashkëpunëtorët dhe furnizuesit. - Kërkesat dhe preferencat e klientëve për të krijuar zgjidhje të personalizuar. - Terminologjia profesionale dhe komunikimit, në ambientin e punës dhe në prezantimet e projekteve. - Mbrojtja e të dhënave dhe informacioneve konfidenciale të klientëve dhe projekteve. - Parimet e punës në grup. - Bashkëpunimi efektiv me eprorët dhe kolegët. - Ankesat dhe mosmarrëveshjet me klientët dhe trajtimi i tyre. - Teknologjitë bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit në menaxhimin e marrëdhënieve me klientit;	
12	Etika, komunikimi dhe sipërmarrja profesionale - Hapat e krijimit të një sipërmarrjeje. - Studimi i tregut për të zhvilluar idenë sipërmarrëse. - Aftësitë për të zhvilluar dhe menaxhuar një projekt sipërmarrës. - Llogaritja e buxhetit për zbatimin e një projekti apo ideje sipërmarrëse. - Rëndësia e mendimit kritik dhe krijues ndaj zgjedhjeve të bëra. - Teknikat e marketingut për promovimin e shërbimeve dhe produkteve. - Vetvlerësimi për identifikimin e nevojave për zhvillim të vazhduar profesional. - Përdorimi i literaturës bashkëkohore për zhvillim profesional dhe përmirësim të praktikave të punës.	5 %
13	Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit - Standardet dhe legjislacioni shqiptar për sigurimin teknik në punë. - Rregullat e sigurimit teknik gjatë punimeve në lartësi. - Rregullat e sigurimit teknik në ambiente elektrike me tension dhe rrezik zjarri. - Pajisjet mbrojtëse individuale dhe kolektive. - Përdorimi i mjeteve dhe pajisjeve të punës. - Pajisjet e mbrojtjes nga zjarri, kontaktit me energjinë elektrike dhe shpëtimit - Dhënia e ndihmës së parë në rast aksidenti ose goditje nga rryma elektrike. - Procedurat e evakuimit për raste emergjence.	5 %
14	Zhvillimi i portofolit profesional - Elementët përbërës të një portofoli profesional - Struktura e portofolit: përmbajtja, organizimi, stili vizual dhe objektivat e tij. - Përdorimi i softuerëve profesionalë për dizajnin dhe prezantimin e tij. - Aftësitë prezantuese dhe teknika të komunikimit profesional.	5 %
TOTALI		100%

Udhëzime për provimin e teorisë profesionale të integruar dhe për vlerësimin:

Provimi i teorisë profesionale të integruar do të jetë me shkrim, me anë të një testi të parapërgatitur nga vetë shkolla. Testi duhet të mbulojë rreth 60% të tematikave mësimore të listuara më sipër. Gjithashtu, rekomandohet që 50% e njësive të testit të jenë me zgjedhje të shumëfishtë (deri në 4 alternativa) dhe pjesa tjetër të jenë njësi testi të tipeve të tjera standarde (me PO ose JO; e Vërtetë ose e Gabuar; me përputhje të përgjigjes së saktë me pyetjen; me plotësim të pjesës që mungon; me plotësim të elementeve të skemës etj.).

Njësitë e testit duhet të jenë të niveleve të ndryshme të vështirësisë, duke ndjekur skemën me tri nivele, si më poshtë:

Niveli I:	Rikujtimi / Të kuptuarit (rreth 40% e pikëve)
Niveli II:	Zbatimi / Analiza (rreth 40% e pikëve)
Niveli III:	Sinteza / Vlerësimi (rreth 20% e pikëve)

Shkolla përcakton numrin maksimal të pikëve të testit dhe harton skemën përkatëse të vlerësimit. Rekomandohet që numri maksimal i pikëve të testit të jetë 50 dhe shpërndarja e pikëve të bëhet në raport me peshën e çdo moduli dhe me nivelet e vështirësisë.

Përcaktimi i pikëve për çdo njësi testi bëhet duke pasur parasysh tipin e njësisë së testit. Kështu, njësitë e testit me zgjedhje të shumëfishtë marrin 1 (një) pikë përkundërt përgjigjes së paracaktuar të saktë. Njësitë e tjera të testit marrin pikë të ndryshme, në varësi nga numri i kërkesave të njësisë së testit.

Skema e konvertimit të pikëve të fituara në nota, rekomandohet të jetë si më poshtë:

Pikët e fituara	Notat
0 - 20	4
21 - 25	5
26 - 30	6
31 - 35	7
36 - 40	8
41 - 45	9
46 - 50	10

B. Programi orientues i Provimit të Praktikës Profesionale të Integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në kualifikimin profesional "Dizenjim dhe dekorim i ambienteve të brendshme", Niveli V në KSHK është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale, në përshkruesit e moduleve profesionale dhe në veprimtaritë e praktikës profesionale të grupuar, në biznes, që përmban skeletkurrikuli përkatës.

Në tabelën e mëposhtme tregohen **kompetencat profesionale** për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **postet e punës, detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

Nr	Kompetencat profesionale	Posti i punës/Detyrat	Pikët
----	--------------------------	-----------------------	-------

1	Të analizojë ambientin dhe të përpilojë kërkesat e dizajnit	Në ambiente që kërkojnë zgjidhje dizajni: banesa, zyra, lokale etj. Detyra 1: “Analiza funksionale dhe estetike e një hapësire”.	25
2	Të hartojë konceptin dhe zgjidhjet kreative për dizajnin e brendshëm	Në studio projektimi ose ambiente të simuluar pune Detyra 2: “Zhvillimi i një koncepti dizajni me moodboard, skica dhe propozime për ngjyra, materiale dhe ndriçim”.	25
3	Të realizojë përpunimin teknik të projektit duke përdorur softuerë profesionalë	Në ambiente me pajisje kompjuterike dhe programe dizajni Detyra 3: “Krijimi i planit teknik dhe pamjeve 3D të projektit të dizajnit të brendshëm me softuer profesional”.	25
4	Të përgatisë dhe të prezantojë portofolin profesional me projektin e realizuar	Në situatë simulimi me klient/punëdhënës ose në ekspozitë/panair Detyra 4: “Portofoli profesional i projektit të realizuar”.	25
Shuma			100

Skema e konvertimit të pikëve të fituara në nota, rekomandohet të jetë si më poshtë:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Udhëzime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të demonstrimit të nxënësve në “poste pune”, në grupe pune ose në mënyrë individuale, në mjedise pune të bizneseve ose në mjediset e praktikave, të shkollës.
- Çdo nxënës vlerësohet individualisht (edhe kur punon në përbërje të grupit).
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave nga çdo nxënës, duhet të jetë jo më shumë se 3 orë, në përputhje me Udhëzimin nr. 15. Datë 26.04.2019 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në arsimin dhe formimin profesional”, në fuqi.
- Në çdo detyrë respektimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit duhet të jenë domosdoshmërisht të përfshira në vlerësim.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t’i lihet hapësirë për vlerësim dhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet anëtarëve të komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuar.

- Nxënësit duhet të punojnë në mënyrë të pavarur, në grupe ose individualisht, pa ndërhyrjen e komisionit, duke u testuar/vlerësuar për proceset e punës, për të katër detyrat, nëpërmjet një sistemi rotacioni.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë Listën e kontrollit që duhet të përmbajë kriterë të vlerësimit për përmbushjen e proceseve/produkteve të punës.
- Lista e kontrollit duhet të përmbajë edhe kriterë për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si puna në grup (kur punohet në grup), vetëkontrolli, përgjegjshmëria, komunikimi me etikë profesionale, siguria në punë, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave.
- Në rast se nxënësi/grupi nuk përmbush dot procedura pune të caktuara dhe kjo pengon ecurinë e mëtejshme të përmbushjes së detyrës, i vlerësimit ndërhyjnë dhe mbështet nxënësin/grupin për tejkalimin e pengesave dhe vijimin e përmbushjes së detyrës.
- Për çdo detyrë komisioni duhet të përgatisë udhëzuesin e përmbushjes për nxënësit, ku do të tregohen hapat për realizimin e detyrës përkatëse.

Realizimi i Detyrës 1: “Analiza funksionale dhe estetike e një hapësire”.

- Nxënësi duhet të testohet për realizimin e proceseve të punës si: Interpretimi i temës së detyrës, analiza e tipareve funksionale të hapësirës, vlerësimi i përmasave dhe formës së hapësirës (planimetri, orientimi, dritaret, dyert etj.), vlerësimi i gjendjes ekzistuese të materialeve, ngjyrave dhe elementeve dekorativë, realizimi i një skice të thjeshtë ilustruese për të paraqitur idetë e para të optimizimit të hapësirës, respektimi i parimeve të ergonomisë, sigurisë dhe aksesueshmërisë në analizë.
- Lloji i hapësirës (p.sh. dhomë ndenjeje, zyrë pune, ambient komercial, etj.), përcaktohet me short për çdo nxënësi/grup.
- Nxënësit/grupit i vihen në dispozicion mjetet dhe materialet e nevojshme për realizimin e detyrës.
- Komisioni i vlerësimit mbikëqyr nxënësin në proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional.
- Nxënësit duhet të vlerësohen në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit (lista e kontrollit) duhet të jetë e njëjtë për të gjithë.
- Kohëzgjatja e përmbushjes së kësaj detyre duhet të jetë jo më shumë se 45 minuta.

Realizimi i Detyrës 2: “Zhvillimi i një koncepti dizajni me moodboard, skica dhe propozime për ngjyra, materiale dhe ndriçim”.

- Nxënësi duhet të testohet për realizimin e proceseve të punës si: Studimi i kërkesave të projektit, përgatitja e moodboard-it (zgjedhja e imazheve, teksturave, ngjyrave dhe materiale inspiruese që reflektojnë stilin dhe funksionin e hapësirës), skicat konceptuale, koncepti i ndriçimit (identifikimi i burimeve natyrore dhe artificiale të dritës si dhe sugjerimi i tipeve të tij).
- Hapësira (p.sh. ambient zyre, dhomë ndenjeje, kafene etj.) që do të realizohet, përcaktohet me short për çdo nxënësi/grup.
- Nxënësit/grupit i vihen në dispozicion mjetet, instrumentet dhe materialet e nevojshme për realizimin e detyrës.
- Komisioni i vlerësimit mbikëqyr nxënësin në proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional.
- Nxënësit duhet të vlerësohen në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit (lista e kontrollit) duhet të jetë e njëjtë për të gjithë.
- Kohëzgjatja e përmbushjes së kësaj detyre duhet të jetë jo më shumë se 45 minuta.

Realizimi i Detyrës 3: “Krijimi i planit teknik dhe pamjeve 3D të projektit të dizajnit të brendshëm me softuer profesional”.

- Nxënësi duhet të testohet për realizimin e proceseve të punës si: interpretimi i konceptit të dizajnit, zhvillimi i planit teknik (2D), modelimi 3D i hapësirës, aplikimi i materialeve në

sipërfaqe të ndryshme (mure, dysHEME, mobilie, etj.), renderimi dhe prodhimi i pamjeve vizuale.

- Hapësira e përzgjedhur për detyrën, përcaktohet me short për çdo nxënës/grup.
- Nxënësit/grupit i vihen në dispozicion mjetet dhe materialet e nevojshme për realizimin e detyrës.
- Komisioni i vlerësimit mbikëqyr nxënësin në proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional.
- Nxënësit duhet të vlerësohen në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit (lista e kontrollit) duhet të jetë e njëjtë për të gjithë.
- Kohëzgjatja e përmbushjes së kësaj detyre duhet të jetë jo më shumë se 45 minuta.

Realizimi i Detyrës 4: “Portofoli profesional i projektit të realizuar”.

- Nxënësi duhet të testohet për realizimin e proceseve të punës si: Zgjedhja e përmbajtjes së portofolit, hartimi i strukturës së portofolit profesional, organizimi grafik i portofolit, përgatitja për prezantim profesional.
- Portofoli mund të jetë në format digjital (PDF, prezantim) dhe/ose të printuar si dosje fizike.
- Nxënësit i vihen në dispozicion pajisje kompjuterike, softuerë grafikë dhe akses në materialet e mëparshme të zhvilluara në projekt për realizimin e detyrës.
- Çdo nxënës përgatit portofolin individualisht.
- Komisioni i vlerësimit mbikëqyr nxënësin në proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional.
- Nxënësit duhet të vlerësohen në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit (lista e kontrollit) duhet të jetë e njëjtë për të gjithë.
- Kohëzgjatja e përmbushjes së kësaj detyre duhet të jetë jo më shumë se 45 minuta.